							<p>ndërmarrë një numër masash në lidhje me delegimet e gjyqtarëve dhe transferimin e përkohshëm. Po në këtë drejtim shërben edhe Vendimi Nr.78 datë 30.05.2019 “për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.</p> <p>Gjithashtu, me vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, KLGJ miratoi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve me qëllim përcaktimin e rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky vendim synon në rritjen e transparencën, meritokracisë dhe në përgjithësi të efikasitetit të gjyqësorit.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Që prej muajit Qershor 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë po e kryen aktivitetin e tij pranë Godinës “Poli i Drejtësisë”, duke plotësuar kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për të përbushur funksionin.</p> <p>Organigrama e miratuar nga Këshilli i Ministrave ka një numër prej 65 punonjësish.</p> <p>Për periudhën Janar- Dhjetor 2020 ka përfunduar procedura e rekrutimit të 12 nëpunësve civilë, si dhe janë kryer 4 rekrutime jashtë shërbimit civil.</p> <p>Aktualisht në KLP rezultojnë 5 vende vakante në shërbimin civil dhe 1 vend vakant për punonjës administrativ.</p> <p>Buxheti vjetor i alokuar ka shumën prej 152 324 (në mijë lekë), ndër të cilat 17 000 (në mijë lekë) janë parashikuar për investime.</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

<p>2. Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe të policisë gjyqësore dhe shpërndarjen e gjykatave në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura gjyqësore me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar qasje në drejtësi.</p>	<p>KL Gj</p>	<p>Zbatimi i hartës gjyqësore.</p>		<p>762.500 lekë</p>			<p>Në proces</p>	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor KL Gj është në proces të përcaktimit të juridiksionit territorial dhe përmasave të gjykatave. Grupi i ndërinstitucional i punës, (i përbërë nga përfaqësues nga gjykatat e vendit, KL Gj, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si: Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të Gjithë” - USAID), bazuar në metodologji dhe standarde ndërkombëtare, pas një analize paraprake, ka përfunduar draftin e hartës së re gjyqësore. Ky draft i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë më datë 29 shtator 2020 dhe është në proces dakordësimi mes dy palëve. Aktualisht KL Gj po vijon punën për analizën e fizibilitetit.</p> <p>Ministria e Drejtësisë Nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, është propozuar përcjellja për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimi “Për riorganizimin e rrethve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”. Kjo nismë do të propozohet në kuadër të punës së përbashkët me KL Gj. Nisma është planifikuar në katërmujorin e tretë të viti 2020.</p>
<p>3. Ngritja e një plani pune për reduktimin e numrit të çështjeve të mbartura.</p>	<p>KL Gj/GJL</p>	<p>Zbatimi i Planit të Veprimit.</p>	<p>2.332 lekë</p>				<p>Realizuar</p>	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor Në lidhje me reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, Këshilli me vendimin Nr.317 datë 19.12.2019, ka miratuar ngritjen e një komisioni të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë. Përballë numrit të jashtëzakonshëm dhe kohës së gjatë të çështjeve në pritje për t’u shqyrtuar dhe në respektim edhe të kriterëve ligjore për gjykimin e tyre, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve vlerësoi se do të vijohet menjëherë me shqyrtimin e rekurseve të çështjeve të themelit, nisur nga kriteri i kohës së paraqitjes së tyre për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, krahas çështjeve të tjera që për nga natyra e tyre dhe sipas ligjit duhet të shqyrtohen në mënyrë të shpejtë, sikurse janë mosmarrëveshjet për juridiksionin, kompetencën, kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve.</p>

							<p>Një masë tjetër e marrë nga Këshilli për ri-funksionimin e Gjykatës së Lartë është miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes KLGJ dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).</p> <p>Mbështetja e administrimit të Gjykatës së Lartë me burime njerëzore për të ulur numrin e çështjeve të prapambetura është ndër kontributet më të rëndësishme që Memorandumi ofron. Për më tepër, memorandumi parashikon përmirësimin dhe modernizimin e proceseve të punës në këtë gjykatë, si dhe zbatimin e TIK-ut në funksion të transparencës dhe marrëdhënieve me publikun.</p> <p>Aktualisht, 12 operatorë janë angazhuar në uljen e numrit të çështjeve të pazgjidhura dhe po punojnë për të krijuar një inventar të detajuar të pothuajse 35,000 çështjeve të mbetura në këtë gjykatë. Ky inventar do të shërbejë si bazë për kategorizimin e çështjeve në grupe, të cilat më pas do të adresohen nga këshilltarët ligjorë dhe gjyqtarët. Konkretisht, angazhimi i tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të këshilltarëve ligjorë dhe të operatorëve, ka bërë që stoku i çështjeve të reduktohet me 1956 çështje.</p> <p>Vlen të përmendet gjithashtu se kohët e fundit, Këshilli, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, ka zhvilluar një Udhëzues për Efikasitetin e Gjykatës së Lartë dhe Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura. Ky dokument, i cili parashikon një sërë masash konkrete, të përqendruara kryesisht në ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të kualifikuar dhe emërimin e më shumë këshilltarëve ligjorë, synon të adresojë situatën e krijuar në këtë gjykatë për shkak të numrit të lartë të çështjeve në pritje.</p> <p>Gjykata e Lartë Në zbatim të dispozitave ligjore për organizimin e Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, duke qenë një nga strukturat drejtuese brenda gjykatës, u mblodh për të diskutuar organizimin e Kolegjeve të Gjykatës. Pas vlerësimit të mendimit të shprehur nga Mbledhja e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Këshilli i Gjykatës vendosi për emërimin e gjyqtarëve në përbërjen e Kolegjeve të Gjykatës dhe emërimin e gjyqtarëve në përbërjen e trupave gjykues (Vendimet nr. 1 dhe nr.2, datë 09.04.2020 të Këshillit të Gjykatës). Që nga momenti i emërimit e deri më tani, Kolegjet e Gjykatës së Lartë kanë vazhduar rregullisht me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, sipas kompetencave përkatëse. Bazuar në të dhënat statistikore të përpunuara nga administrata e Gjykatës së Lartë, për periudhën Prill - 9 Korrik 2020, Kolegjet e Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar në total 866 çështje, nga të cilat: 400 çështje administrative; 216 çështje penale dhe 250 çështje civile (ku përfshihen: shqyrtimi gjyqësor i themelit të çështjes, përcaktimi i juridiksionit dhe kompetencës, masa sigurie, kërkesa për pezullim / revokim të vendimit të gjykatave më të ulëta etj).</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

Nën-objektivi 1/c: Përmirësimi i llogaridhëniens së institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e perealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Krijimi i Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, të ngarkuar me përgjegjësinë për të verifikuar ankesat, hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjithë niveleve, anëtarëve të KLGJ e KLP, Prokurorit të Përgjithshëm dhe për të zhvilluar shërbime të tjera të inspektimit në gjykata dhe prokurori në pajtim me standardet evropiane.	Kuvendi i RSH ILD	75 përqind e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të procesohen sipas afatit ligjor	74.211 lekë		40.174 lekë		Në proces	<p>Ministria e Drejtësisë Në lidhje me procedurat e brendshme të funksionimit, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është përgatitur projektvendimi ‘Për krijimin e kushteve për inspektorin e Lartë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe kriterëve ligjore, verifikimin e figures dhe pasurisë së kandidatëve jomagjistratë’, i cili është miratuar me vendimin nr. nr.536, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 110, datë 29.07.2019. Shënim: e realizuar për sa i takon MD-së, konkretisht hartimi i akti nënligjor refueuar si më sipër.</p> <p>Kuvendi i Republikës së Shqipërisë Kuvendi ka përmbushur funksion kushtetues atë të zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka miratuar strukturën e këtij organi.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë Për periudhën Shkurt-Dhjetor 2020, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë depozituar:</p> <p>950 ankesa të depozituara, nga të cilat:</p> <p>756 ankesa nga qytetarët;</p> <p>185 ankesa nga institucione të tjera (pa përfshirë fondin e parë 757 ankesa nga KLGJ-ja);</p>

								<p>9 ankesa nga organizatat;</p> <p>757 ankesa të marra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si ankesa të mbartura (fondi i parë në muajin Qershor 2020);</p> <p>Bazuar në nenet 121 dhe 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, lidhur me shqyrtimin e ankesave gjatë periudhës Shkurt- Dhjetor 2020, janë miratuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 130 vendime për arkivimin e ankesave; - 42 vendime për verifikimin e ankesave; <p>Ndaj vendimeve të arkivimit të ankesave të sipërcituara, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë ankimuar 16 vendime të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <p>Po ashtu, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (dhe ish-KLD), gjatë periudhës Gusht-Shtator 2020, janë depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 1347¹ praktika (praktika të inspektimit të ish-KLD), për trajtimin e të cilave është ngritur një grup pune me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka vijuar trajtimin e tyre me përparësi sipas objektit.</p> <p>Bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenet 194/3 dhe 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka miratuar 7 vendime për fillimin e hetimit disiplinor, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendimi nr. 313/7 datë 02.04.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit...”; - Vendimi nr. 251/11 datë 22.05.2020 “Për
--	--	--	--	--	--	--	--	---

¹Praktika të inspektimit të ish-KLD.

							<p>fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurores....”; - Vendimi nr. 664/4 datë 07.07.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit....”; - Vendimi nr. 705/1 datë 2.05.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares....”; - Vendimi nr. 1751 datë 16.07.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares....”; - Vendimi nr. 1752 datë.16.07.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorit....”; - Vendimi nr. 2987/2 datë 17.12.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit....”;</p> <p>Nga këto hetime disiplinore të kryera: 2 prej tyre konkretisht për një magjistrat prokuror dhe një magjistrat gjyqtar janë hetime disiplinore të iniciuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 5 kërkesa për procedim disiplinor për tre magjistratë gjyqtarë dhe një magjistrat prokuror janë hetime disiplinore të iniciuara nga ankesat e subjekteve drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <p>Aktualisht, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor janë duke zhvilluar procedurat disiplinore bazuar në vendimet e sipërcituara për fillimet e hetimeve disiplinore.</p> <p>Për periudhën Shkurt- Dhjetor 2020 nga Inspektorit i Lartë të Drejtësisë, janë ngritur 4 (katër) kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, 3(tre) pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe 1(një) pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, konkretisht:</p> <p>Kërkesë nr. 251/31 prot., datë 21.07.2020 “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor për magjistratin.....”; Kërkesë nr. 313/43 prot., datë 30.07.2020 “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor për magjistratin”; Kërkesë nr. 664/14 prot., datë 22.09.2020 “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor për magjistratin”; Kërkesë nr. 1751/17 prot., datë 10.12.2020 “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor për magjistratin”;</p> <p>Në përfundim të shqyrtimit në seancë dëgjimore publike të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve, për dy nga rastet e</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>sipërpërmendura Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar kërkesën e Inspektorit të lartë të Drejtësisë për procedimin gjyqësor ndaj magjistratëve dhe është vendosur mbarimi i mandatit të tyre, për njërin rast Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur rrezimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj magjistratës... dhe rasti i katërt është në procedurë e sipër.</p> <p>Bazuar në pikën 4 të nenit 194 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryen dhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrisë të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.</p> <p>Në zbatim të kësaj dispozite, bazuar në planin vjetor të Inspektimeve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar këto vendime:</p> <p>Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirimin me Kusht”;</p> <p>Vendim Nr. 1/1 datë 20.02.2020 “Për shtimin e objektit të inspektimit tematik të caktuar me vendimin nr. 1 datë 11.02.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;</p> <p>Lidhur me ecurinë e inspektimeve tematike të sipërpërmendura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në fazën e përpunimit të të dhënave të dërguara nga gjykatat sipas vendimeve të mësipërme.</p>
2. Hartimi dhe publikimi i standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes për magjistratët si dhe monitorimi i zbatimit të tyre.	KLJGJ/ KLP	Monitorim i zbatimit të standardeve. Zbatimi i procedura ve.	17.250 lekë	17.250 lekë			<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e rregullave dhe kodit të etikës dhe për monitorimin e tyre, dhe specifikisht Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, po konsideron me prioritet përgatitjen e draftit të parë të standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të</p>

							Në proces	<p>sjelljes të gjyqtarëve, sipas Ligjit nr. 115/2016.</p> <p>Me vendimin nr. 208, datë 11.10.2019, KLGJ caktoi një gjyqtar si këshilltar për etikën.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Nuk ka ende zhvillime për periudhën e raportimit.</p>
3. Hartimi i bazës nënligjore mbi procedurat dhe kriteret e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave të propozuara disiplinore ndaj gjyqtarëve e prokurorëve.	KLGJ KLP	Zbatimi i procedurave		7.500 lekë			Realizuar	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor KLGJ, në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLGJ “Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave”, miratoi me vendimin Nr. 316, datë 14/09/2020 rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor.</p> <p>Ky akt normativ përcakton elementet kryesore procedurale dhe materiale të ecursisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore.</p> <p>Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjithë niveleve.</p> <p>Kjo rregullore përcakton:</p> <p>a) kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetarit, relatorit dhe anëtarëve, si dhe detyrat e këshilltarit ligjor përgjegjës të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe të personelit administrativ të Këshillit;</p> <p>b) marrëdhëniet e Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare, me këshilltarin ligjor përgjegjës të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve, personelin administrativ të Këshillit, ankuesin, gjyqtarin dhe Inspektorin e Lartë i Drejtësisë;</p> <p>c) rregulla për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e</p>

							<p>dokumentacionit që lidhet me procedurat disiplinore; ç) rregulla për krijimin, trajtimin, qarkullimin, shfrytëzimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që bëhet pjesë e dosjes së procedurës disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve pjesëmarrëse në këtë dokumentacion.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Është miratuar Rregullorja “Mbi funksionimin e Komisionit Disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”.</p>
<p>4. Përmirësimi i transparencës së procesit të vlerësimit të masave disiplinore.</p>	<p>KLGJ</p>	<p>Anonimizimi dhe publikimi në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve.</p>	<p>8.000 lekë</p>	<p>3.750 lekë</p>		<p>Realizuar</p>	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor KLGJ, me vendimin Nr. 316, datë 14/09/2020 mbi rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor, përcakton edhe aspektet e njoftimit të akteve:</p> <p>1. Aktet e procedurës sipas kësaj rregulloreje i njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:</p> <p>a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;</p> <p>b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;</p> <p>c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.</p> <p>2. Vendimi i Këshillit bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimitetit të subjekteve, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.</p> <p>Gjithashtu, kjo rregullore, në nenin 34 vlerëson publicitetin e seancës dhe më tej në nenin 43 publikimin e vendimeve disiplinore:</p> <p>1. Këshilli publikon, brenda 2 javëve, çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magjistratëve në faqen zyrtare.</p> <p>2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore, duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojtë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magjistratit.</p>

								<p>Aktualisht, në bashkëpunim me ILD-në, nga ana e KLGJ janë zhvilluar dy procedura disiplinore dhe në përfundim është pranuar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin e dy gjyqtarëve.</p> <p>Në lidhje me procedimin e tretë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 646, dt 23.12.2020, është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë dëgjimore dhe nga Komisioni Disiplinor po kryhen të gjitha procedurat paraprake për përgatitjen e kësaj çështje dhe zgjidhjen e saj brenda afateve ligjore.</p>
5. Reduktimi i vonesave në vlerësimin vjetor periodik të magistratëve.	KLJGJ	4 vjet vonesë (backlog) KLGJ ka vlerësuar të paktën 90% të gjyqtarëve sipas planit vjetor të VLERESIMIT	57.150 lekë				Në proces	<p>Një tjetër element i rëndësishëm për karrierën e gjyqtarëve është edhe plotësimi i kuadrit nënligjor për krijimin e skemës së vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve. Në këtë kuadër janë hartuar edhe aktet nënligjore për realizimin e këtij procesi me synim (i) përmirësimin e vazhdueshëm të aspektit etik dhe profesional të gjyqtarëve; (ii) vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve; (iii) zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe (iv) identifikimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues.</p> <ul style="list-style-type: none"> • vendimi nr. 263, datë 21.11.2019 “për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” • vendimi nr. 264, datë 21.11.2019 “për miratimin e metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” • vendimi nr. 316, datë 19.12.2019 “për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” • vendimi nr. 120, datë 05.03.2020 “për miratimin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit” • vendimi nr. 197, datë 11.06.2020 “për miratimin e rregullave për përzgjedhjen

								<p>me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”</p> <p>Programi i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve për vitin 2020 është miratuar nga KLGJ me vendimin Nr. 276, datë 10.12.2019 dhe parashikon vlerësimin e 121 gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.</p> <p>Këshilli, me vendimin nr. 198, datë 11.06.2020 (18 gjyqtarë) dhe me vendimin nr. 233, datë 02.07.2020 (3 gjyqtarë), filloi procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe caktoi relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar. Aktualisht ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për gradimin e 21 (njëzetënjë) gjyqtarëve;</p> <p>Përgjatë vitit 2020, nga ana e Këshillit, me vendimet nr. 247, datë 09.07.2020, nr.314, datë 14.09.2020, nr.337, datë 24.09.2020 dhe nr. 634, datë 16.12.2020, ka filluar për 42 gjyqtarë të cilët kanë kandiduar për ngritje në detyrë, procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, për vitin kalendarik 2019.</p> <p>Në tërësi, në vitin 2020, kanë filluar dhe janë në proces, procedurat e vlerësimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016 – 27 gjyqtarë; - Vlerësim 3/vjeçar për periudhën e vlerësimit 2017-2019 – 1 gjyqtar; - Vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2019- 42 gjyqtarë. <p>KLGJ, me vendimin Nr.645, datë 23.12.2020, miratoi programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021.</p> <p>Në lidhje me planifikimet 3/mujore të fillimit të procesit të vlerësimit, vendimi nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>etik dhe profesional të gjyqtarëve”, përcakton se: “Këshilli miraton brenda muajit nëntor të çdo viti, programin vjetor të vlerësimeve etike dhe profesionale. Programi vjetor përmban, për aq sa është e mundur, edhe planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit si dhe lehtësimin e zhvillimit të shortit”.</p> <p>Në zbatim të dispozitës së mësipërme, planifikimet 3/mujore të vlerësimeve bëhen pjesë e programit të vlerësimit, për aq sa është e mundur. Duke marrë në konsideratë faktin që ky është programi i dytë i vlerësimeve pas krijimit të KLGJ-së, situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar si dhe për shkak të pezullimit ose reduktimit të herë pas hershëm të veprimtarisë për shkak të pandemisë, vendet vakante që mund të hapen, kërkesat për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele... etj, KLGJ vlerëson që planifikimet 3/mujore të vlerësimeve të miratohen me vendim të veçantë të Këshillit, mbi bazën e të cilit do të fillojë edhe procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar si dhe të fillojnë në muajin Mars 2021 duke u ndarë në 3 programe të veçanta 3/mujore. Ndërkohë muajt e parë të vitit 2021 do të shërbejnë për përfundimin e procedurave të vlerësimit të filluara në vitin 2020.</p> <p>Prioritet e planifikimeve 3/mujore të programit të vlerësimit 2021, janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kryerjen me përparësi të të gjitha vlerësimeve me procedurë të përshpejtuar të detyruar; 2. Gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë; 3. Vlerësimin e gjyqtarëve të komanduar si ndihmësmagjistratë apo atyre të komanduar në Këshill, në rast aplikimi prej tyre për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele; 4. Vlerësimin normal për periudhën 01 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2019 të të gjithë gjyqtarëve.
--	--	--	--	--	--	--	--	--

Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit dhe formimit ligjor si edhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave
Nën-objektivi 2/a: Kualifikimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit të gjykatës sipas standardeve/kërkesave evropiane

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1.Thellimi dhe zgjerimi i aktivitetit të Shkollës së Magjistraturës në drejtim të rekrutimit dhe ofrimit të programeve trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe kategoritë e tjera të personelit të gjykatave dhe prokurorive nëpërmjet përmirësimit të programit të rekrutimit dhe kurrikulave për kandidatët për magjistratë, si dhe krijimi i kurrikulave të reja dhe moduleve të trajnimit për kategoritë e tjera.	SHM	Përmirësi m kurrikula për vitin e dytë të formimit fillestar përkandidatët magjistratë/ndihmës ligjorë. Zhvillohen 3 kurrikula të reja dhe të paktën një kurs online për trajnimin e vazhdueshëm		2.681 lekë 670 (*20)	31,950.710 lekë	5,016.000 lekë	Realizuar	<p>Shkolla e Magjistraturës</p> <p>Lidhur me Programin e Formimit Fillestar Rekrutimi</p> <p>a) Numri i kandidatëve për magjistratë, këshilltarë e ndihmës ligjor në periudhën Janar – Qershor 2020:</p> <p>Në vit të parë: 58 kandidatë në total, prej të cilëve: 24 kandidatë për gjyqtarë, 22 kandidatë për prokurorë, 4 kandidatë Këshilltar Ligjorë dhe 8 kandidatë për ndihmës ligjor</p> <p>Në vit të dytë: 6 kandidatë per magjistratë, të gjithë gjyqtar.</p> <p>Në vit të tretë: 15 kandidatë për magjistratë, prej te cileve 13 kandidatë për gjyqtar dhe 2 kandidatë për prokuror.</p> <p>Në Qershor u diplomuan dhe emëruan 19 kandidatët për gjyqtar dhe 2 kandidatët për prokuror.</p> <p><u>Provimi i pranimit</u></p> <p>Në muajin qershor u zhvillua provimi i pranimit për vitin akademik 2020-2021.</p> <p>b) Numri i kandidatëve për magjistratë, këshilltarë e ndihmës ligjor në periudhën Qershor – Dhjetor 2020:</p> <p>Në vit të parë: 80 kandidatë gjithsej, prej të cilëve: 42 kandidatë për gjyqtarë, 27 kandidatë për prokurorë, 6 kandidatë për këshilltar ligjor dhe 5 kandidatë për ndihmës ligjor.</p> <p>2 kandidatë për gjyqtarë dhe 2 kandidatë për prokurorë, 5 kandidatë për këshilltar ligjor dhe 3 kandidatë për ndihmës ligjor nuk janë konfirmuar akoma nga Këshillat.</p>

							<p>1 kandidat për prokuror u përjashtua nga KLP, duke e cuar numrin ne 26.</p> <p>2 kandidatë për ndihmës ligjor kanë kërkuar pezullim te ndjekjes së Programit të Formimit Fillestar për këtë vit.</p> <p><u>Programet mësimore</u></p> <p>Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Qendrën Hollandeze të Studimeve dhe Trajnimit Gjyqësor (SSR) dhe Misionin Euralius V, pas miratimit të kurrikulës mësimore të vitit të parë të Programit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarë ë ndihmës ligjorë, përmbylli edhe procesin e rishikimit të Planit mësimor të vitit të dytë të Programit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë, duke e orientuar atë më tepër drejt praktikës dhe aftësive e kompetencave që duhet të ketë gjyqtari/prokurori.</p> <p>Procesi i rekrutimit dhe realizimi i Programit të Formimit Fillestar për këtë periudhë ka pasur një kosto prej 8485710 lekë.</p> <p>Lidhur me Programin e Formimit Vazhdues</p> <p>Në periudhën janar 2020-dhjetor 2020, Shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar gjithsej 133 aktivitete trajnuese, nga të cilat 95 aktivitete janë realizuar nga Shkolla dhe 38 aktivitete janë realizuar me mbështetjen e donatorëve.</p> <p>Kosto e trajnimeve nga buxheti i shtetit për këtë periudhë ka qenë 23465000 lekë. Lidhur me mbështetjen financiare të donatorëve, fondet administrohen prej tyre, megjithatë, referuar koston së një aktiviteti trajnues, mbështetja e donatorëve ka qenë në vlerën e përafërt prej 5016000 lekë.</p> <p>Kategoritë e personave të trajnuar janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kandidatë për magjistratë që ndjekin Programin e Formimit Fillestar në vitin e tretë dhe që, sipas ligjit, kanë detyrimin për trajnim në Programin e Formimit
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>Vazhdues;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjyqtarë të gjykatave të rretheve gjyqësore; - Gjyqtarë të gjykatave të apelit; - Gjyqtarë të gjykatave administrative të shkallës së parë; - Gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit; - Prokurorë të prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore; - Prokurorë të prokurorive pranë gjykatave të apelit; - Inspektorë të ILD; - Ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë; - Ndihmës ligjorë të Gjykatës Administrative të Apelit; - Avokatë shteti; - Këshilltarë ligjorë në Prokurorinë e Përgjithshme; - Oficerë të policisë gjyqësore pranë prokurorive; - Pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; - Nëpunës të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit. <p>Lidhur me kurrikulat për kancelarët</p> <p>Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Euralius V ka punuar intensivisht për përshtatjen e kurrikulave për kancelarët e prokurorive dhe është në fazat e përmbylljes së këtij procesi.</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

<p>2. Transformimi gradual i Shkollës së Magjistraturës në një qendër burimore dhe pikë takimi për të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ofrimi i kushteve optimale të trajnimit për magistratët dhe personelit të gjykatave. Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore për Shkollën e Magjistraturës.</p>	<p>KLGJ, SHM</p>	<p>Përfundim i i fazës së parë të punimeve. Raport vjetor progresi.</p>	<p>798.345 lekë 306.345 lekë ('19) 246.000 lekë ('20) 246.000 lekë lekë ('20)</p>				<p>Në proces</p>	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor KLGJ sugjeron të rishikohet roli i saj si institucion përgjegjës, pasi në bazë të ligjit nr. 115/2016 “për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara në ligj. KLGJ nuk ka rol as në përfundimin e fazës së parë të punimeve dhe as në përgatitjen e raportit vjetor të progresit. (dy objektivat për vitin 2020).</p> <p>Për sa i përket bashkëpunimit mes KLGJ dhe SHM, vlen të theksohet që KLGJ ka dhënë opinion në mbledhjen plenare të datës 2 korrik 2019 për draft programin tematik 2019-2020 të ShM si dhe kurrikulat e trajnimit 8 javor për kancelarët e gjykatave. Gjithashtu, një pjesë e anëtarëve të KLGJ kontribuojnë edhe në rolin e lektorëve të ftuar në trajnimin fillestar në ShM, si edhe të ekspertëve në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve. Këshilli, në lidhje me komandimin e gjyqtarëve si pedagogë të brendshëm, ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës dhe ka treguar kujdesin maksimal për të siguruar transparencë të plotë në vendimmarrje dhe rritje të kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës.</p> <p>Shkolla e Magjistraturës Lidhur me objektivin strategjik për të transformuar Shkollën në një qendër burimore studimi dhe kërkimesh shkencore, Shkolla ka ndërmarrë disa hapa konkretë duke rritur kapacitetet e saj në këtë drejtim. Në strukturëmn e Shkollës, në dhjetor 2020 është shtuar një pozicion i ri, emërtuar “Këshilltar për botimet dhe publikimet shkencore”, pozicion i cili synon të bëjë hapa cilësorë drejt realizimit të këtij objektivi strategjik. Gjithashtu, Rregullorja e botimeve ka pësuar ndryshime, që pritet të nxisin studimin dhe botimin. Lidhur me infrastrukturën: Shkolla e Magjistraturës duke filluar nga muaji Tetor 2019 është zhvendosur, përkohësisht, në ambiente të reja, të cilat plotësojnë pjesërisht kërkesat për zhvillimin normal të programit të formimit fillestar të</p>
---	------------------	---	---	--	--	--	------------------	--

							<p>kandidatëve për magjistratë dhe kandidatëve për këshilltar e ndihmës ligjorë, kancelarëve, avokatëve të shtetit, gjithashtu dhe të nevojave të programit për trajnim të vazhduar të magjistratëve në detyrë. Në këto ambiente i jepet zgjidhje e përkohëshme edhe nevojave për hapësira më të përshtatshme pune për stafin akademik dhe administrativ të Shkollës. Me VKM nr.234, dt. 17.04.2019, Shkolla e Magjistraturës do të ushtrojë veprimtarinë e saj në të njëjtën godinë me KLGJ dhe KLP. Për periudhën Janar-Shtator 2019 nuk ka asnjë kosto nga ana e Shkollës.</p> <p>Në vijim të procedurave për ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magjistraturës, në respektim të afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me studion projektuese, në dhjetor të vitit 2019 është dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), Projekti i Zbatimit për ndërtimin e saj. Vlera e parashikuar e ndërtimit dhe e mobilimit është rreth 529.923.000 lekë.</p>
3. Rritja dhe përmirësimi i punës kërkimore shkencore nëpërmjet pasurimit të fondit të bibliotekës dhe sigurimi i aksesit në bibliotekat digjitale.	SHM	100 libra literature vendase dhe të huaj, botime shkencore	<p>6 048 lekë ;</p> <p>2 170 lekë ('19);</p> <p>1 939 lekë ('20);</p> <p>1 939 lekë ('21)</p>		647.480 lekë	Realizuar	<p>Shkolla e Magjistraturës</p> <p>Në periudhën janar-dhjetor 2020 janë botuar 5 revista, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Revista “Jeta juridike”, nr. 3, e vitit 2019, 300 kopje; - Revista “Jeta juridike”, nr. 1, e vitit 2020, 300 kopje; - Revista “Jeta juridike”, nr. 2, e vitit 2020, 300 kopje; - Magjistrati 11, 300 kopje; - Magjistrati 12, 300 kopje; <p>Këto tituj kanë një kosto financiare totale prej 647480 lekë, nga buxheti i shtetit.</p> <p>Gjithashtu, është botuar teksti “Manual, Kodi i Drejtësisë penale për të mitur, programet e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit”; autor: Prof. Dr Mariana Tutulani Semini dhe Prof. Dr Arta Mandro; botim i Shkollës së Magjistraturës, financuar nga Bashkimi Evropian, Fondacioni Terres des Homes. Edhe ky tekst është botuar në 300 kopje.</p> <p>Numri i njësive bibliotekare të shtuara përgjatë kësaj periudhe është 24 gjithsej, ku të gjitha janë</p>

								donacione.
4. Trajnime dhe kualifikime për ngritjen e kapaciteteve të këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi.	GJK	Seanca trajnimesh për aspektet e reja të juridiksionit	23.700 lekë				Në proces	<p>Gjykata Kushtetuese</p> <p>Ka vijuar procesi i trajnimeve dhe kualifikime për ngritjen e kapaciteteve këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi.</p> <p>Nuk parashikohet të realizohen trajnime të tjera për shkak se pjesa tjetër është zbritur në kuadër të shkurtimeve të fondeve në zbatim të Aktit Normativ nr. 28, datë 02.07.2020, Udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e Buxhetit 2020, detajimin e ndryshimeve të planit të buxhetit për shpenzimet korrente, për Gjykatën Kushtetuese</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në bashkëpunim me OSCE-në po realizojmë Planin Strategjik të Gjykatës Kushtetuese. • Është realizuar një aktivitet me fondet e OSCE-së dhe Konrad Adenauer Stiftung në muajin korrik. Edhe kjo masë e realizuar. • Për 6 mujorin e dytë parashikojmë realizimin e aktiviteteve të tjera në lidhje me Planin Strategjik me fondet e donatorëve. <p>Hartimi i rregullores së re së punës të Gjykatës Kushtetuese e cila do të përshtatet ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore.</p> <p>Gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 99 kërkesa, nga këto:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 kërkesa kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare; - 12 kërkesa kanë kaluar për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve; - Për 54 kërkesa është marrë vendim moskalimi; - 30 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit

								<p>paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese.</p> <p>- lidhur me buxhetin e shpenzuar (faktik), ju bëjmë me dije se, për realizimin e veprimtarisë gjyqësore kushtetuese, në fillimin e vitit 2020, Gjykatës Kushtetuese i është miratuar një buxhet total prej <u>147,000, mijë lekë</u>, i cili pas dy akteve normative të Këshillit të Ministrave u reduktua në vlerën e <u>115,000, mijë lekëve</u>. Në këtë buxhet janë përfshirë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzimet operative, si dhe fondi i investimeve. Në total janë realizuar <u>98.462. mijë lekë</u>.</p>
<p>Objekti 3: Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen në gjykatë në përputhje me standardet evropiane Nën - objekti 3/a: Përmirësimi i transparencës në funksionimin e sistemit gjyqësor (Shënim: masat në lidhje me efikasitetin janë përfshirë nën Objektivin 1b)</p>								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e përfunduar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Rritja e marrëdhënieve të gjykatave me median dhe sigurimi i qasjes së publikut në informacione për rastet me interes publik.	KLJG	Trajnimi i këtij grupi target. Sigurimi i mjeteve logjistike	500 lekë	4.000 lekë			Realizuar	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor KLGJ, në vijim të punës dhe arritjeve të vitit 2019 (përcaktimi i anëtarit për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, miratimi i “Programit të transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratimi i Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë për vitet 2019-2020, caktimit të gjyqtarëve për mediat, në çdo juridiksion apeli, etj.) gjatë vitit 2020 ka përfunduar hartimin e Projektit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor,</p>

							<p>nëpërmjet të cilit synohet përcaktimi i bazave për përmirësimin marrëdhënies të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve.</p> <p>Po ashtu, KLGJ ka miratuar (vendimi nr. 592 datë 26.11.2020) rregulloren “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median”, nëpërmjet të cilës përcaktohen parimet, rregullat dhe procedurat e veçanta për komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj. Në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje, duke synuar krijimin e lehtësirave për aksesimin e informacionit për përfaqësuesit e mediave, do të ndërtohet dhe vihet në funksionim një rubrikë e veçantë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.</p> <p>Në datën 22 janar 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi së bashku me Projektin “Drejtësi për të gjithë” (USAID), një aktivitet me gjyqtarët për mediat, nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënies me publikun, si edhe me disa gazetarë që mbulojnë çështjet e drejtësisë.</p> <p>Me ndihmën e projektit u mundësua edhe vënia në funksionim e faqes së re të internetit http://klgj.al/ ku pasqyrohet në mënyrë transparente e gjithë veprimtaria e KLGJ.</p>
2.Publikimi elektronik në kohë i vendimeve të gjykatave si dhe analizave vjetore të gjykatave / raporte efëçence dhe përditësimi i rregullt i faqes gjykata.gov.al.	KLJGJ	Zbatimi në masën 100%	18.000 lekë				<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>Nga ana e gjykatave kryhet publikimi i të gjitha vendimeve, por Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve ICMS nuk mundësonte procesin automatik të fshirjes së të dhënave personale në tekstin e vendimeve gjyqësore.</p> <p>Në vijim të punës së bërë gjatë vitit 2020 dhe në zbatim të detyrimeve ligjore që vijnë nga ligji Nr. 9887 dt.10/03/2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen e të</p>

									<p>Dhënave Personale, është mundësuar anonimizimi automatik i të dhënave sensitive. Anonimizimi është gjithashtu i vlefshëm dhe për vendimet e viteve të kaluara.</p> <p>Benefitet e këtij zhvillimi lidhen drejtpërdrejt me uljen e investimeve si në fushën e burimeve njerëzore ashtu dhe në koston e blerjes së një softëare-i të jashtëm për automatizimin automatik.</p> <p>Faqja www.gjykata.gov.al është në fazën e prokurimit. Megjithatë, në vijim të përmirësimeve të bëra gjatë vitit 2020 dhe në funksion të transparencës dhe orientimit të publikut, janë shtuar në menu-në kryesore një numër rubrikash informative.</p> <p>KLJGJ, në bashkëpunim me Projektin “Justice for All”, është duke punuar për krijimin e një portali elektronik të unifikuar të sistemit gjyqësor ku KLJGJ dhe të gjitha gjykatat do të kenë faqen e tyre të dedikuar. Ky portal do të mundësojë një transparencë më të mirë të veprimtarisë gjyqësore të gjykatave.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Nën-objektivi 3/b: Përmirësimi i aksesit në sistemin e drejtësisë


Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1.Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF) është krijuar dhe ka funksionalitet të plotë.	MD	Krijimi i regjistrit elektronik funksional për menaxhim in e të dhënave për ndihmën juridike parësore dhe dytësore; Kalendar i mbajtur për fushatat	86.500 lekë		10.330 lekë		Realizuar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas Funksionimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas ² me kapacitet të plotë: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrisë të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër Nr. 59, datë 25.03.2019

		ndërgjegjë suese;						<p>“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndihmës Juridike Falas” me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Bazuar në strukturën e miratuar nga Kryeministri, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, ka në përbërje të saj drejtoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtori i Përgjithshëm; - Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore; - Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike; - Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse. <p>Sa i përket ecurisë së rekrutimeve bëjmë me dije se: Me Urdhër nr. 201, datë 01.7.2020, të Ministrisë të Drejtësisë është emëruar Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (TND).</p> <p>Për tre drejtorët e drejtorive të ndihmës juridike, janë shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, vendet vakante të mbetura, referuar strukturës së DNJF dhe konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore (Shpallja me nr. 3086); - Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike (Shpallja me nr. 3083); - Drejtor i Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse (Shpallja me nr. 3082). <p>Afati i dërgimit të dokumentacionit për procedurën e “lëvizjes paralele” dhe “ngritjes në detyrë” për këto pozicione përfundon më datë 30.09.2020. Në varësi të aplikimeve dhe përmbushjes së kriterëve, pritet që procedura e shpalljes së fituesve të përfundojë brenda muajit Tetor 2020, duke plotësuar kështu strukturën e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe bërjen të mundur të funksionimit me kapacitete të plota.</p>
--	--	-------------------	--	--	--	--	--	--

							<p>Në muajin Gusht me aktin nr.2942 prot., datë 16.07.2020, DAP ka njoftuar emërimin e e Specialistit të Arkiv/Protokoll Sekretare nga lista e fituesve, ndër të tjera po në muajin gusht janë rinovuar kontaktat me punonjësit e qendrës Tiranë. Ndërsa përgjatë muajit Shtator DNJF ka përfunduar procedurat e rekrutimit të punonjësve me trajnim të posaçëm për qendrën e Lushnjes (hapur më 8 shtator 2020), qendrën e Pogradecit dhe atë të Gjirokastrës (të cilat priten të inagurohen gjatë muajit tetor 2020).</p> <p>Muaji Shtator shënon një arritje të rëndësishme sa i përket miratimit të akteve të fundit nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2017, duke plotësuar kështu të gjithë kuadrin ligjor në fushën e ndihmës juridike. Tashmë, ligji nr.111/2017 është plotësuar dhe ndiqet nga 13 akte nënligjore të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar çdo fushë specifike të ndihmës juridike dhe kanë sjellë një serë risish e procedurash të reja. Procedura e hartimit dhe miratimit të akteve është një procedurë e cila është ndjekur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë sipas përcaktimeve të ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Pas një procesi të gjatë bashkëpunimi me aktorët përgjegjës në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti në muajin Shtator 2020 u bë i mundur miratimi i dy prej akteve nënligjore më të rëndësishme sa i përket mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike dytësore, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 5.8.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”; - Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nr. 17 datë 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”. <p>Këto akte përcaktojnë rregulla të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për qytetarët në proceset civile dhe administrative në zbatim të parimit të rotacionit, si dhe kriteret dhe tarifave e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>shpërblimit për këtë shërbim. Në kuadër të hyrjes në fuqi të këtyre 2 akteve u zhvillua një aktivitet prezantues më datë 16.09.2020, me pjesëmarrjen e Zëvendës Ministrit të Drejtësisë, përfaqësuesve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore; Dhomave Vendore të Avokatisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë si dhe ekspertëve të fushës.</p> <p>Që nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së tyre, specialistët e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë angazhuar në hartimin e akteve të brendshme me karakter rregullues, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas; - Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (shtojcë e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë). <p>Kjo rregullore i është përcjellë për miratim Ministrit të Drejtësisë me shkresën me nr. 243/1 datë 20.08.2020.</p> <p>Gjithashtu, DNJF ka propozuar që si pjesë e kësaj rregulloreje të përfshihet edhe kreu nr. VI “Organizimi dhe funksionimi i komisionit vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikantëve për financim të ojf të autorizuara dhe komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të ojf të autorizuara që përfitojnë financim nga buxheti i shtetit” si nje detyrim i përcaktuar në pikën 13 të VKM nr. 110 datë 06.03.2019, “ Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” ku përcaktohet se: “Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit vlerësues dhe komisionit të ankimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë”.</p> <p>Miratimi i Rregullores së Brendshme të DNJF do të jetë një tjetër hap i rëndësishëm në funksion të mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit të këtij institucioni duke synuar parashikime të detajuara</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>dhe rregulla specifike për çdo proces të parashikuar nga ligji. Shtojca që i bashkëlidhet kësaj rregullore synon standardizimin e rregullave dhe procedurave dedikuar qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, si ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore të shpërndara në qarqe të ndryshme të vendit.</p> <p>Krijimi i regjistrit elektronik funksional për menaxhimin elektronik të të dhënave për ndihmën juridike parësore dhe dytësore:</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është duke bashkëpunuar me EURALIUS dhe SOROS për krijimin dhe bërjen funksionale të CMS (Case Management System), që do të shërbejë për gjenerimin e të dhënave për ndihmën juridike parësore dhe dytësore.</p> <p>Krijimi i këtij sistemi është në proces. Në funksion të tij, janë kryer disa takime me ekspertët e kontraktuar nga donatorët.</p> <p>Funksionimi i sistemit si një bazë totale e të dhënave të shërbimeve të ndihmës juridike është në proces dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike është duke vlerësuar se cili sistem është më i përshtatshëm për të përmbushur objektivat që DNJF ka sa i përket administimit dhe kontrollit të të dhënave.</p> <p>Kalendari i fushatave ndërgjegjësuese:</p> <p>Lidhur me ndërgjegjësimin , DNJF ka hartuar një kalendar aktivitetesh dhe ka vijuar me një sërë aktivitetesh si më poshtë (shih masat në vijim).</p>
2. Sistemi i Ndhmës Juridike Parësore ka funksionalitet të plotë.	DNJF	Mbulohen 90% e nevojave për ndihmë parësore në shkallë vendi 4 qendra të tjera të shërbimit të ndihmës juridike; Janë zhvilluar fushta ndërgjegjë suese Ngritja dhe funksioni mi i klinikave ligjore pranë universiteve private; Program të trajnimit vazhdues për ofruesit e ndihmës juridike (ASPA; donator);	29 000				<p>Realizuar</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas</p> <p>Në zbatim të kësaj mase janë ndërmarrë një sërë aktivitetesh të cilat kanë shënuar disa zhvillime kryesore.</p> <p><u>Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore:</u></p> <p>Referuar planit të punës Korrik - Dhjetor 2020, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vijuar me procedurat në kuadër të hapjes së qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</p> <p>Më datë 08 shtator 2020, u zhvillua inagurimi i qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore në</p>

							<p>qytetin e Lushnjes duke shënuar kështu hapjen e qendrës së parë me buxhetin e shtetit.</p> <p><i>Aktualisht, qytetarët përfitojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në 7 qendra të shërbimit të ndihmës juridike, konkretisht:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë (në bashkëpunim me OSFA); - Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës (në bashkëpunim me UNDP); - Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Fier (në bashkëpunim me UNDP); - Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Lezhë (në bashkëpunim me UNDP); - Qendra e shërbimit të ndihmës juridike në Lushnje (me buxhetin e shtetit). - Qendra e shërbimit të ndihmës juridike në Pogradec (në bashkëpunim me UNDP); - Qendra e shërbimit të ndihmës juridike në Gjirokastrë (në bashkëpunim me UNDP); <p> Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore</p> <p>Pranë ambjenteve të Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj u zhvillua më datë 01.09.2020, një takim pune me punonjësit me trajnim të posaçëm në Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lezhë.</p> <p>Në këtë takim ju kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi mënyrat e sensibilizimit të qytetarëve dhe nxitjen e tyre për të marrë shërbimin ligjor falas pranë këtyre qendrave. Tashmë me qendrat funksionale në këto qytete, qendren e re të inaguruar në qytetin e Lushnjes më datë 08.09.2020, si dhe me qendrat e reja që janë planifikuar për t'u hapur</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>përgjatë këtij viti, do të mundësohet rritja e aksesit të qytetarëve që do të përfitojnë nga ndihma juridike falas, si një ndër prioritetet kryesore të Minitrisë së Drejtësisë.</p> <p>Gjatë këtij takimi nga ana e zj. Ministre u theksua rëndësia e shërbimit të ndihmës juridike e ofruar nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Është shumë e rëndësishme që qendrat të bashkëpunojnë ndërmjet tyre me qëllim ndarjen e vizionit të përbashkët sipas rrethit ku ato operojnë. Një qasje tjetër që duhet patur parasysh në këtë kuadër është analiza nga ana e qendrave për kërkesat e trajtuara dhe grupimin e tyre sipas target grupeve që adresohen pranë këtyre zyrave. Një analizë e tillë do të shërbejë për nevojat dhe kërkesat që variojnë nga njëri qytet në tjetrin në funksion të politikës së zgjerimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas nevojave të evidentuara më sipër.</p> <p>Gjithashtu, në fokus të veçantë duhet të jetë puna e vetë qendrave për të shtuar rastet që adresohen pranë qendrave duke vijuar me promovimin sa më shumë të jetë e mundur të shërbimit ligjor falas dhe sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.</p> <p>Në këtë kuadër, qendrat duhet të punojnë për të forcuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile në drejtim të zhvillimit të fushatave sensibilizuese; takimeve të përbashkëta mbi problematikat mbi çështjet e ndihmës juridike; hartimit dhe publikimit të materialeve të vizibilitetit si dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta. Ecuria dhe zhvillimet e qendrave si dhe numri i rasteve të trajtuara do të luajnë rol kryesor në vijueshmërinë e këtyre zyrave duke krijuar qëndrueshmëri institucionale sa i përket ndihmës juridike parësore.</p> <p>Lidhur me shërbimin e ndihmës juridike parësore i ofruar përmes qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, rezulton se për periudhën Janar – Dhjetor 2020, janë trajtuar gjithsej 1426 raste.</p> <p><u>Bashkëpunimi me Klinikat e Ligjit pranë</u></p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>Institucioneve të Arsimit të Lartë:</p> <p>DNJF është duke bashkëpunuar me 9 Klinikat Ligjore me të cilat janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore”, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë; 2. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Bedër; 3. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Ëisdom; 4. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin European të Tiranës; 5. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës; 6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Ismail Qemali Vlorë; 7. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Qiriazi; 8. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar; 9. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër). <p>Në funksion të shtrirjes së këtij bashkëpunimi, më datë 28.10.2020, u zhvillua takimi i parë teknik me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë këtij takimi u diskutua për rolin që u është atribuar me ligj Klinikave të Ligjit, si ofrues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas dhe masat që duhen ndërmarrë me qëllim vendosjen e tyre në të njëjtën linjë me Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara. Pavarësisht se ndodhemi në kushtet e një viti të ri akademik sfidues, referuar masave kufizuese të ndërmarra për shkak të pandemisë, nga</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe përfaqësuesve të Klinikave u shpreh angazhimi maksimal dhe gadishmëria për bashkepunim të mëtejshëm.</p> <p>Klinikat e Ligjit kanë ofruar shërbim ligjor falas për 41 raste.</p> <p><u>Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse për dhënien e ndihmës juridike parësore:</u></p> <p>Një nga risitë thelbësore të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është përcaktimi i organizatave jofitimprurëse të autorizuara si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</p> <p><i>Për herë të parë parashikohet një procedurë tërësisht e re, procedurë e cila ka për qëllim të autorizojë dhe financojë Organizata Jofitimprurëse për të ofruar ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti</i> në rrethin ku këto organizata operojnë.</p> <p>Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, një ndër ofruesit e ndihmës juridike parësore janë organizatat jofitimprurëse të cilat do të autorizohen nga Ministri i Drejtësisë përmes një procedure të detajuar e cila është e parashikuar në dy akte nënligjore të dala në zbatim të ligjit 111/2017, dhe konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Vendimi nr. 55 datë 06.02.2019</u>, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”; - <u>Vendimi nr. 110, datë 06.03.2019</u>, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p><i>shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”.</i></p> <p>Organizatat jofitimpruëse krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.</p> <p><i>Ka përfunduar i gjithë procesi i autorizimit të OJF-ve në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Ministrisë së Drejtësisë</i> dhe më datë <u>10.09.2020</u>, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrit të Drejtësisë të 12 organizatave jofitimpruëse të autorizuar me një shtritje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat. Organizatat Jofitimpruëse të autorizuar janë si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara; 2. Shërbimi Ligjor Falas “TLAS”; 3. Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Qytetare dhe Fshatare Berat”; 4. Qendra “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”; 5. Shoqata “Shërbimet Shqiptare për Refugjatët dhe Migrantët”; 6. Shoqata Intelektualët e Rinj Shpresë; 7. Qendra “A.L.T.R.I.”; 8. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare; 9. Qendra “Konsumatori Shqiptar”; 10. Shoqata “Forumi i Gruas Elbasan”;
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>11. Shoqata “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”;</p> <p>12. Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë”.</p> <p>Jo vetëm do të përfitohet shërbim ligjor falas, por do të garantohet gjithashtu cilësi dhe profesionalizëm në ofrimin e këtij shërbimi. OJF-të e autorizuar përfitojnë financime nga buxheti i shtetit si dhe i nënshtrohen kontrollit dhe mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në kuadër të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë mbi “<i>Kriteret e vlerësimit, metodologjia dhe procedurat e mbikëqyrjes të ndihmës juridike</i>”.</p> <p>Autorizimi i OJF-ve është një procedurë e re, një mekanizëm i ri që krijohet në funksion të rrjetëzimit të institucioneve që ofrojnë ndihmën juridike falas. Përvoja në fushën e ndihmës juridike, eksperiencia e gjatë e organizatave në këtë kuadër, është një garanci e shtuar për çdo qytetar që do të përfitojë nga shërbimet ligjore falas. Gjithashtu, vlen të theksohet shpërndarja gjeografike e këtyre organizatave nëpër rrethe e qytete të ndryshme (Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër), duke bërë të mundur kështu shtrirjen sa më të gjerë dhe mbulimin me shërbime ligjore falas në pothuaj të gjithë territorin e vendit.</p> <p>Nga momenti i autorizimit më datë 10 shtator 2020 dhe deri në Dhjetor 2020, OJF-të e autorizuar kanë trajtuar 960 raste dhe kanë ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore.</p> <p>Dhënia e ndihmës juridike ONLINE</p> <p>Në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e pandemisë (Covid-19), u mbyllën qendrat e ndihmës parësore, dhe një pjesë e procesve të punës u pezulluan, duke qënë një shërbim ngushtësisht i lidhur me qytetarin, kurrësesi ndihma juridike nuk mund të mos ofrohej dhe në këto kushte kufizimi.</p> <p>Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës juristonline.al. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me gjithë legjislacionin e miratuar në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.</p> <p>Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ.</p> <p>Kjo platformë ka rezultuar mjaft e sukseshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre.</p> <p>Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas është cilësia e këtij shërbimi. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet së është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit. DNJF si institucioni kompetent në kuadër të vlerësimit të cilësisë të këtij shërbimi është duke vijuar të analizojë me kujdes përgjigjet e avokatëve/juristëve të angazhuar në platformë si dhe kohën e kthimit të tyre me qëllim përcjelljen e sugjerimeve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit, gjë për të cilën do të shprehemi në seksionin e monitorimit të ofrimit të cilësisë së shërbimit.</p> <p>Ndihma juridike online nëpërmjet platformës juristonline.al është ofruar për 1524 raste.</p> <p>Vendosja në dispozicion e numrit të gjelbër</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>(falas) 08001010</p> <p>Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin SOROS kanë vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën do të kenë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosija e një numri falas sidomos gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma juristonline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime sa më pranë qytetarit. Si platforma ashtu edhe numri i gjelbër po vijojnë të funksionojnë në shërbim të çdo qytetari duke krijuar kështu një garanci të shtuar për sigurimin e aksesit të barabartë në drejtësi.</p> <p>Ndihma juridike nëpërmjet numrit të gjelbër është ofruar për 240 raste.</p> <p><u>Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore ³ (Kryerja e monitorimit fillestar për çdo qendër të re të shërbimit të ndihmës juridike parësore; kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore; monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat; dërgimi i raporteve mujore narrative mbi ecurinë e punës; hartimi i raporteve të monitorimit / vlerësimi i performances). <p>1. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

³ Raportin Përmbledhës të monitorimeve e gjeni bashkëlidhur.

								<p>juridike në Tiranë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi tre mujor i kryer më datë 13.08.2020 si dhe monitorimi i vazhdueshëm i kryer me datë 22.12.2020; - Analizë e Raporteve mujore narrative. <p>2. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike në Durrës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi tre mujor i kryer më datë 15.07.2020; - Analizë e Raporteve mujore narrative. <p>3. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike në Fier.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi tre mujor i kryer më datë 23.07.2020; - Analizë e Raporteve mujore narrative. <p>4. Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në Lezhë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi tre mujor i kryer më datë 11.08.2020; - Analizë e Raporteve mujore narrative. <p>5. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike në Lushnje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i kryer më datë 04.12.2020 - Analizë e Raporteve mujore narrative. <p>6. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike në Pogradec.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizë e Raporteve mujore narrative.
--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>- Në proces, datë 30.12.2020 monitorimi pranë ambjenteve të qendrës.</p> <p>7. Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në Gjirokastrë</p> <p>- Analizë e Raporteve mujore narrative.</p> <p>8. Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në Shkodër</p> <p>- Analizë e Raporteve mujore narrative.</p> <p>Pas kryerjes së monitorimeve janë hartuar raportet përmbledhëse sipas përcaktimeve të metodologjisë së miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Gjithashtu, jemi në proces të hartimit të raporteve përfundimtare të performancës për juristët / avokatët e çdo qendre shërbimi. Është hartuar raporti përmbledhës për të gjitha monitorimet e kryera për ndihmën juridike parësore.</p> <p><u>Lidhur me fushatat e ndërgjegjësimit</u>, DNJF, bazuar në Ligjin nr 111/2017, ka ndër të tjera, detyrimin ligjor për të zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për ndihmën juridike falas si dhe ngarkohet me përgjegjësinë e edukimit ligjor të publikut duke mos u ndalur vetëm tek sistemi i ndihmës juridike falas por dhe më gjerë. Nisur nga ky detyrim ligjor, dhe nga aktivitetit konkret në këtë plan veprimi, DNJF gjatë gjashtë-mujorit të parë ka realizuar disa aktivitete me karakter ndërgjegjësues, të cilat do të vijojnë përgjatë gjithë vitit, si një detyrim që shtrihet në kohë dhe është në proces. Me qëllim përmbushjen e këtij objekti, Drejtoria e Ndihmës Falas ka hartuar një plan të detajuar masash , dedikuar posaçërisht aktiviteteve dhe seminareve ndërgjegjësuese/informuese.</p> <p>1. Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore.</p> <p>- <i>Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore</i></p> <p>Pranë ambjenteve të Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj u zhvillua më datë 01.09.2020, një takim pune me</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>punonjësit me trajnim të posaçëm në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Falas në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lezhë.</p> <p>Në këtë takim ju kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi mënyrat e sensibilizimit të qytetarëve dhe nxitjen e tyre për të marrë shërbimin ligjor falas pranë këtyre qendrave.</p> <p style="text-align: center;">– Aktivitet Ndërgjegjësues “Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin”, Kavajë, 09 Mars 2020</p> <p>Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelmore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjisllacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti".</p> <p>Ligji 111/2017, "Për Ndhmën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçëm të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Konkretisht, fëmijët që jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror; fëmijët në kujdestari, të cilët kërkojnë të fillojnë një proces pa pëlqimin e përfaqësuesit të tyre ligjor ose kundër përfaqësuesit të tyre ligjor; viktimat mitur dhe të miturit në kundërshtim me ligjin, në çdo fazë të procedurës penale (për të cilën nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme), mund të përfitojnë që nga këshillimi ligjor (ndihma juridike parësore) deri në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë (ndihmë juridike sekondare).</p> <p>Gjithashtu, duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve, është detyrim ligjor që juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>ndihmës jurike falas, të jenë të specializuar në sistemin e Drejtësisë për të mitur përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/ Dhoma Kombëtare e Avokatisë.</p> <p>Pavarësisht lehtësirave që ka sjellë ky ligj në kuadër të përfitimit të shërbimit ligjor falas, vihet re se nga të miturit apo familjarët e tyre, nuk ka kërkesa për përfitim të ndihmës ligjore falas. Kjo mund të jetë si shkak i mungesës së informacionit mbi këtë shërbim . Në këto kushte, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është planifikuar zhvillimi i një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuere duke u ndalur veçanërisht tek kategoritë e veçanta të ligjit.</p> <p>Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktiviteti “<i>Akresi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin</i>” i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Re-Integritit të të Miturve Kavajë.</p> <p>Ky aktivitet u zhvillua në 3 seksione ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas.</p> <p>Të miturit gjatë takimit informues u shfaqën mjaft të interesuar për t’u informuar mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi. Shumica prej tyre i shprehën problematikat ligjore më të cilat përballen familjarët e tyre të cilat lidheshin më së tepërmi me “detyrimin për ushqim” si dhe me kërkesat për “revokimin e avokatëve të caktuar kryesisht”.</p> <p>Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përfitimin e shërbimit nga këta të mitur, përfaqësuesit e DNJF shkëmbyen kontaktet me Punonjësit Socialë të Qendrës së Re-Integritit të të Miturve Kavajë të cilët ishin mëse të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>Falas në trajtimin e këtyre rasteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Tryezë e Përbashkët në kuadër të promovimit dhe nxitjes së sistemit të ndihmës juridike falas, Elbasan 05 Mars 2020</i> <p>Më datë 5 Mars DNJF me zhvilloi një tryezë të përbashkët me përfaqësues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse. Qellimi i kesaj tryeze konsistonte në rendesine dhe efikasitetin që duhet te ketë Sistemi i Ndihmës Juridike Paresore dhe fokusin për te rritur urat e bashkëpunimit nderinstitucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari t'i garantohet akses në Drejteësi. Tryeza rezultoi mjaft frytdhënëse në kuadër të lidhjes së urave të bashkëpunimit me aktorët ndër institucionalë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Intervista televizive me qëllim përcjelljen e njohurive mbi sistemin e ndihmës juridike falas tek qytetarët</i> <p>Më datë 17 qershor 2020⁴, 2 specialistë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë ftuar në emisionin “Mirmëngjes Shqipëri” në Radio Televizionin Shqiptar gjatë të cilit është diskutuar mbi ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas gjatë periudhës së pandemisë, sistemin e ndihmës juridike falas, ofruesit e këtij shërbimi dhe kategoritë përfituese.</p> <p>Në muajin Nëntor të vitit 2020 është realizuar intervista televizive me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec dhe kryetarit të Dhomës Vendore të Avokatisë Korçë në të cilën është folur mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

⁴ Linku i intervistës: <https://youtu.be/tv-4ëtNcODg>

								<p>ligjor të publikut.</p> <p>Këto intervista kanë vijuar të zhvillohen përgjatë muajit dhjetor me qëllim përbushjen e objektivit të DNJF lidhur me promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas dhe edukimin ligjor të publikut.</p> <p style="text-align: center;">- Takim me organizatat jofitimprurëse të autorizuar që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti.</p> <p>Më datë 10.09.2020, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrisë të Drejtësisë të 12 organizatave jofitimprurëse të autorizuar me një shtrirje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat. Gjatë këtij takimi u vu theksi në prioritetin që i jepet ndihmës juridike falas, në realizimin e së cilit kanë qenë mbështetës aktorët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Organizatat jofitimprurëse krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.</p> <p style="text-align: center;">- Takim prezantues i dy akteve të fundit nënligjore të miratuara për Ndihmën Juridike Falas.</p> <p>Në kuadër të hyrjes në fuqi të akteve nënligjore mbi tarifat dhe rotacionin e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore u zhvillua një aktivitet prezantues më datë 16.09.2020, me pjesëmarrjen e Ministrisë të Drejtësisë; përfaqësuesve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore; Dhomave Vendore të Avokatisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë si dhe ekspertëve të fushës. Këto akte përcaktojnë rregulla të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për qytetarët në proceset civile dhe administrative në zbatim të parimit të rotacionit, si dhe kriteret dhe tarifat për këtë shërbim. Normimi i parimit të rotacionit siguron një proces</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>gjithëpërfshirës, transparent dhe më efektiv në përzgjedhjen e avokatëve që do të përmirësojë edhe shërbimin e ndihmës juridike dytësore për qytetarët në tërësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit. <p>Publikimi i manualit “Si të përfitojmë ndihmë juridike falas”</p> <p>DNJF në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja “d” dhe “e” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas. Manuali për ndihmën juridike u është përcjellë disa institucioneve si Bashkia Tiranë, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Kryeministrisë në kuadër të nxitjes dhe bashkëpunimit .</p> <ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend. <p>DNJF në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, ka zhvilluar një sërë takimesh me EURALIUS V19 sa i përket përmbajtjes së posterave. Në muajin Shtator 2020 u bë i mundur dizejnimi dhe printimi i mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërore në gjithë Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Gjithashtu, janë hartuar dhe vendosur në dispozicion të qytetarëve fletëpalosje të dedikuara për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>- <i>Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare⁵ në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve.</i></p> <p>Që prej muajit Mars 2020, është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.</p> <p>- <i>Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram.</i></p> <p>Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët dhe duke marrë parasysh faktin se ky shërbim është relativisht i ri dhe i panjohur për të shumtën e qytetarëve, DNJF është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram të cilat janë mjaft të përdorshme nga qytetarët. Kemi vijuar me postime të vazhdueshme informative mbi procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe janë mbajtur komunikime të vazhdueshme me qytetarët të cilët na janë drejtuar për të kërkuar informacion.</p> <p>- <i>Përfshirja e sistemit të ndihmës juridike falas si E-shërbim në platformën E-albania.</i></p> <p>Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët, promovimi dhe informimi mbi këtë sistem është një element kyç në kuadër të rritjes së aksesit të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Si një mjet mjaft i mirë në kuadër të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me shkresën nr. 371 prot., datë 23.09.2020 i ka propozuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencisë Kombëtare të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

⁵ <https://ndihmajuridike.gov.al/>

								<p>Shoqërisë së Informacionit, përfshirjen e ndihmës juridike falas si E-shërbim në Platformën E-ALBANIA. Kjo platformë, sidomos periudhën aktuale për shkak të pandemisë Covid-19, ka një përdorim mjaft të gjerë ndaj edhe përfshirja e E-shërbimit “Ndhmë juridike falas” do të ketë një impakt në rritjen e nivelit të informacionit të qytetarëve mbi këtë sistem. Që prej datës 17 Dhjetor 2020, Të gjithë shtetasit tashmë mund të përfitojnë shërbimet e këshillimit ligjor direkt nga <i>e-albania</i> bashkë me të gjitha shërbimet e tjera online⁶.</p> <p>- <i>Ëëbinar mbi procedurën e administrimit të të dhënave dhe raportimit nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore”, Tetor 2020.</i></p> <p>Qëllimi kryesor i këtij Ëëbinari ishte diskutimi në terma teknikë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit në kuadër të rasteve të trajtuara, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore.</p> <p>Janë pikërisht këto të dhëna, të administruara nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike të cilat do të shërbejnë për hartimin e politikave të ndryshme në këtë kuadër si dhe do të jenë një indicie për evidentimin e nevojave për ndryshime ligjore.</p> <p>- <i>Takim Online me Klinikat e Ligjit, Tetor 2020.</i></p> <p>Më datë 28.10.2020 u zhvillua takimi i parë teknik me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Gjatë këtij takimi u diskutua për rolin që u është atribuar me ligj Klinikave të Ligjit, si ofrues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas dhe masat që duhen ndërmarrë me qëllim vendosjen e tyre në të njëjtën linjë me Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Organizatat Jofitimprurëse të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

⁶ https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=787&service_type=N

							<p>Autorizuara.</p> <p>Pavarësisht se ndodhemi në kushtet e një viti të ri akademik sfidues, referuar masave kufizuese të ndërmarra për shkak të pandemisë, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe përfaqësuesve të Klinikave u shpreh angazhimi maksimal dhe gadishmëria për bashkepunim të mëtejshëm.</p> <p>- <i>Ëëbinar mbi Standardet e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë” Nëntor 2020.</i></p> <p>Qëllimi kryesor i këtij Ëëbinari ishte diskutimi në terma teknike dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në kuadër të standardeve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë.</p> <p>Diskutimi u përqëndrua në disa tematika kryesore si: Risitë e ligjit nr.111/2017, në kuadër të mekanizimit të mbikëqyrjes së cilësisë; Standardet e reja dhe indikatorët e vlerësimit të sanksionuara në Metodologjinë e miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe zbatimi në praktikë referuar problematikave të nxjerra nga monitorimet e kryera.</p> <p>- <i>Takim me Shoqatën “Unë, Gruaja” Nëntor 2020.</i></p> <p>Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, si një nga aktorët mbështetës për projektin “Ligji është jetë – Mbrojeni jetën tuaj!” mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata Shoqata Une, Gruaja për Vullnetarët e Ligjit me temë: “Rritja e kapaciteteve për grupet mbështetëse në lidhje me informacionin ligjor për publikun dhe qasjen e tij në drejtësi”.</p> <p>Ky trajnim u organizua në kuadër të projektit: “Ligji është jetë- Mbrojeni jetën tuaj!” i cili po zbatohet nga Shoqata “Unë, Gruaja” në Korçë dhe Pogradec me mbështetjen UNDP Albania dhe fonde të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>Agjencisë Austriake për Zhvillim.</p> <p>Projekti “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministria e Drejtësisë dhe financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA)”</p> <p>- <i>Trajnimi ne Ëëbinar i stafit të DNJF me Euralius V, Dhjetor 2020.</i></p> <p>Stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe i Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në datë 10.12.2020 u angazhua në trajnimin e organizuar nga Euralius V mbi ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me pjesëmarrjen e Z. Thomas Traar dhe Zj. Arta Vorpsi.</p> <p>Stafi diskutoi mbi arritjet e deritanishme dhe problematikat e hasura në praktikë nga kadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.</p> <p>- <i>Afishimi i posterit “Ke nevojë për ndihmë juridike”, në ambientet e pushtetit qendror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Dhjetor 2020.</i></p> <p>Në përbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, garantimit të aksesit në drejtësi për çdo qytetar, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e qeverisjes e nivelit qendror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Në këtë kuadër, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vijuar me komunikimet me qëllim promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke kërkuar nga institucionet shtetërore afishimin e posterave “Ke nevojë për ndihmë juridike”.</p> <p>Këto postera janë konceptuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>bashkëpunim me Euralius V, ku platforma jurstionline.al dhe numri i gjelbër 0801010 janë financuar nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe kanë për qëllim kryesor ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si element thelbësor i aksesit në drejtësi.</p> <p>- <i>Nënshkrimi i 25 marrëveshjeve “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, Dhjetor 2020.</i></p> <p>Në përbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, “Sigurimit të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive, për të gjithë kategoritë përfituese”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka nënshkruar 25 marrëveshje me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë me objekt :“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.</p> <p>Duke vlerësuar maksimalisht rolin që kanë Gjykatat në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, këto marrëveshje janë një vlerë e shtuar në përbushje të misionit të DNJF.</p> <p>2. Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit</p> <p>- <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Fierit, Nëntor 2020.</i></p> <p>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.</p> <p>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>qytetin e Fierit ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimiti gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Prokuroria; Bashkia; Shtëpia e të moshuarve; ADISA.. etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <p>- <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës, Nëntor 2020.</i></p> <p>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.</p> <p>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Lezhës ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimiti gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Prokuroria; Bashkia; etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <p>- <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Tiranës, Nëntor 2020.</i></p> <p>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimiti gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <p>- <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Durrësit, Dhjetor 2020.</i></p> <p>Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimiti gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <p>- <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Shkodrës, Dhjetor 2020.</i></p> <p>Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takim informues me qytetarë të komunitetit Romë dhe Egjiptian në Shkozë, Tiranë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Nëntor 2020.</i> <p>Ekipi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas organizoi një takim me qytetarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës, Tiranë, bashkë me përfaqësuesit e Klinikës Ligjore Ëisdrom, me të cilët është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas.</p> <p>U zhvillua një bashkëbisedim mbi problematikat ligjore të qytetarëve, të cilat do të adresohen për t'u trajtuar në Klinikën e Ligjit Ëisdrom dhe Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë.</p> <p><u>Forcimi i kapaciteteve / trajnime të kryera:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Forcimi i kapaciteteve të Stafit të DNJF <p><i>Bashkëpunimi me Euralius</i></p> <p>Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas më datë 10.12.2020, pati mundësinë të zhvillonte trajnimin e organizuar nga Euralius V mbi ligjin “<i>Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti</i>” me pjesëmarrjen e ekspertëve të kontraktuar nga Euralius, Z. Thomas Traar dhe Zj. Arta Vorpsi. Stafi pati mundësinë të diskutonte në terma teknike mbi problematikat e hasura në praktikë nga kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta duke marrë në konsideratë dhë praktikën ndërkombëtare.</p> <p>Trajnime të kësaj natyre do të zhvillohen në vijimësi edhe përgjatë vitit 2021, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare në kuadër të aktiviteteve/projekteve të përbashkëta të cilat do të parashtrihen më në detaje në kapitullin 7 të këtij raporti.</p> <p style="text-align: center;">– Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</p> <p>DNJF ka patur një komunikim të vazhdueshëm me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8 të ligjit nr.111/2017, në të cilin parashikohet se: <i>“Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm”</i>.</p> <p>Nga ana e ASPA-s, me shkresën me nr. 7006/4 prot., datë 31.01.2020, u miratua Draft Programi i trajnimeve (trajnimi fillestar i detyrueshëm), hartuar nga DNJF për punonjësit me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Nga ana tjetër, me shkresën me nr. 386/2, datë 22.05.2020, ASPA bën me dije se referuar VKM nr. 138, datë 12.03.2014 <i>“Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të ASPA-s dhe trajnimin e nëpunësve civilë”</i>, konkretisht kreu III, përcaktohet se: <i>“Për personat jashtë shërbimit civil (siç janë punonjësit me trajnim të posaçëm, marrëdhënia e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës), paguhet tarifa prej 3000 (tre mijë) deri në 7000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi, në varësi të</i></p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>kohëzgjatjes së kursi” .</p> <p>Sa më sipër, në kushtet kur buxheti i DNJF është i pamjaftueshëm për trajnimin e detyrueshëm e punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF kërkoi nga ana e UNDP mbështetjen qoftë atë financiare (pagesa e trajnimeve të ASPA-s), ose qoftë përmes zhvillimit të këtij trajnimi nga ana e një eksperti të kontraktuar.</p> <p>UNDP u shpreh e gatshme për zhvillimin e një trajnimi paraprak të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes angazhimit të disa ekspertëve dhe më datë 24.09.2020, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas u zhvillua sesioni i parë trajnues gjatë të cilit punonjësit e qendrave patën mundësi të diskutojnë në terma praktikë ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike sipas kategorive specifike të ligjit.</p> <p>Ky trajnim i paraprin zhvillimit të trajnimeve të detyrueshme të punonjësve nga ana e ASPA me bashkëpunimin dhe mbështetjen e UNDP. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, më datë 14 Dhjetor 2020, u mundësua zhvillimi i një takimi të përbashkët mes UNDP, DNJF dhe ASPA ku u diskutua në mënyrë të përgjithshme mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i kurrikulës (nëse ka një tekst bazë; printimi duhet të jetë në standard afatgjatë; nëse ky modul mund të përdoret nga Aspa për trajnime në vijim); - Pjesëmarrësit kanë mundësi që të reflektojnë mbi leksionet e marra gjatë sesionit të trajnimit dhe ti paraqesin këto reflektime në sesionin vijues; - Dhënia e çertifikatës (çertifikata bazohet në një proces vlerësimi i cili kryhet specifikisht sipas nevojave të çdo pjesëmarrësi. Vlerësimi mund të bëhet përmes caktimit të detyrave / një prezantimi nga trajnuesi për pjesëmarrësit sipas nevojave që ata kanë prezantuar
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>edhe gjatë trajnimit);</p> <ul style="list-style-type: none"> - U theksua bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike sa i përket këtij projekti; - Punonjësit e Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (për qendrat aktualisht të hapura dhe ato që do të hapen në vijim), janë target grupi i parë që do të trajnohen; - Nevojat për trajnim janë reflektuar në termat e referencës të cilat janë diskutuar dhe rënë dakord me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. (është diskutuar në disa takime me DNJF lidhur me nevojat konkrete për trajnim të punonjësve te qendrave); - Moduli që do të hartohet për këto trajnime mund të përdoret nga të gjithë ata që ofrojnë shërbime (inkurajohet përdorimi i gjerë i këtij moduli); Do të jetë 1 Modul trajnimi i cili do të përfshijë disa tematika ashtu sikurse parashikohet në ligj dhe sikurse e kërkojnë nevojat e punonjësve. <p>Objektiv i DNJF është zhvillimi i këtyre trajnimeve brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021, duke u reflektuar në mënyrë të detajuar në Planin e ri të Punës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. <p>DNJF, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional, i është drejtuar DhASh me shkresë Nr. 396 Prot., datë 01.10.2020, bazuar në kompetencat që rrjedhin nga ligji Nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", neni 9, gërma d) parashikon si detyrë të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë përgatitjen dhe organizimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>Ndihmës Juridike Falas.</p> <p>Ky parashikim ligjor gjen mbështetje dhe në ligjin nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ku në kapitullin VII “Edukimi profesional i avokatit” nenet 52 e 55, 30 përcaktohet se: Avokatët që do të përfshihen në listën e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, kryejnë trajnim specifik mbi fusha të së drejtës të lidhura me kategoritë përfituese të ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, duke ia atribuuar këtë kompetencë Shkollës së Avokatisë, si organ i ngritur për të realizuar këtë qëllim.</p> <p>DNJF ka lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore për vitin 2020 me 73 avokatë në rang vendi, listuar sipas Dhomave Vendore të Avokatisë. Si rrjedhojë, nga ana jonë është propozuar që trajnimi vazhdues të zhvillohet për të 73 ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore. Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka hartuar draft programin e trajnimit vazhdues të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, në të cilin janë parashikuar tema specifike duke u përqëndruar kryesisht në ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, në fokus të veçantë për trajnimin vazhdues janë parashikuar edhe nëntema të lidhura specifikisht me kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulnerabël, sikurse parashikohen në ligj.</p> <p>Objektiv i DNJF është zhvillimi i këtyre trajnimeve brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021, duke u reflektuar në mënyrë të detajuar në Planin e ri të Punës.</p> <p style="text-align: center;">– Zhvillimi i ëbinareve nga DNJF</p> <p>Në kuadër të njohjes së ofruesve të shërbimit me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore qoftë sa</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket procedurës së mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit, DNJF ka zhvilluar disa ëbinare me qëllim diskutimin më në detaje të akteve nënligjore dhe konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ëëbinar datë 29 Tetor 2020, “<i>Mbi procedurën e administrimit të të dhënave dhe raportimit nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore</i>”, me pjesëmarrjen e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Organizatave Jofitimprurëse të autorizuar dhe Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve. Qëllimi kryesor i këtij ëëbinari ishte diskutimi në terma teknikë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit në kuadër të rasteve të trajtuara, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore. Janë pikërisht këto të dhëna, të administruara nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike të cilat do të shërbejnë për hartimin e politikave të ndryshme në këtë kuadër si dhe do të jenë një indicie për evidentimin e nevojave për ndryshime ligjore. 2. Ëëbinar datë 22 Nëntor 2020, “<i>Mbi Standardet e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë</i>”, me pjesëmarrjen e <ul style="list-style-type: none"> - Avokatëve të ndihmës juridike dytësore; - Përfaqësues nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë; - Përfaqësues nga Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë; - Përfaqësues nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore dhe - Përfaqësues nga Organizatat
--	--	--	--	--	--	--	--

								Jofitimprurëse të autorizuar. Qëllimi kryesor i këtij ëbinari ishte diskutimi në terma teknike dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në kuadër të standardeve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë.Diskutimi u përqëndrua në disa tematika kryesore si: Risitë e ligjit nr.111/2017, në kuadër të mekanizimit të mbikëqyrjes së cilësisë; Standardet e reja dhe indikatorët e vlerësimit të sanksionuara në Metodologjinë e miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe zbatimi në praktikë referuar problematikave të nxjerra nga monitorimet e kryera.
3. Sistemi i Ndhmës Juridike Dytësore ka funksionalitet të plotë.	DNJF; Gjykatat; DHKA; SHM	75% e nevojave janë përmbush ur, përfshi edhe grupet vulnerabël në të njëjtën masë; Janë zhvilluar fushata ndërgjegjë suese;	135 000				Realizuar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas Ndhma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë ⁷ , në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12 të ligjit nr.111/2017. Për vitin 2020 janë lidhur kontrata me 73 avokatë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore sipas listës së miratuar nga DhASH, të ndarë për secilën dhomë vendore avokatie, në rang vendi. DNJF në përmbushje të detyrave të saj funksionale të parashikuara në nenin 22 të ligjit 111/2017, po vijon me ndjekjen e seancave gjyqësore me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore me qëllim procedimin me ankimimin e tyre nëse kërkesat me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore janë dukshëm abuzive ose haptazi të pabazuara. Aktualisht, është përpiluar një kërkesë ankimore ndaj Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë Nr. 41 ,datë 22.07.2020, me kërkesë zj. Violeta Marku, pasi Gjykata ka keqinterpretuar dispozitën ligjore (neni 19) duke mos e legjitimuar zj. Marku për ngritjen e kërkesës për përfitim ndihme juridike

⁷ Në vijim, DhASH.

							<p>dytësore për vajzën e saj, duke i mohuar kërkuases të drejtën kushtetuese për të përfituar avokat falas.</p> <p>Gjithashtu, DNJF ka proceduar me kërkesa për ndreqje gabimesh të vendimeve gjyqësore për dhënie ndihme juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga pagimi i tarifave apo shpenzimeve gjyqësore , të cilat kanë rezultuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Caktim nga ana e gjykatës të avokatit që do të përfaqësojë kërkuasin në procesin gjyqësor përkatës në dispozitiv vendimi, duke përvetësuar kompetencat që ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ia atribuon Dhomave Vendore të Avokatisë;</i> - <i>Moszbatim parashikimesh të nenit 23 të ligjit Nr.111/2017, duke mos ia komunikuar vendimin përkatës subjekteve të përcaktuara në dispozitiv;</i> - <i>Mosparashikim i të drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqësor dhe afatit për paraqitjen e tij, në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit 22 pika 9 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;</i> - <i>Disponim mbi kërkesë për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, kërkesë kjo e cila nuk është bërë nga ana e kërkuarit dhe as identifikuar ne objektin e kërimit.</i> <p>Totali i Vendimeve Gjyqësore për periudhën Janar – Dhjetor 2020 = 181 vendime gjyqësore.</p> <p>Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore (Kryerja e monitorimit fillestar për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore; kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore; hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës).
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>Procesi i mbikëqyrjes ka vijuar edhe për avokatët e ndihmës juridike dytësore përmes kryerjes së monitorimeve fillestare pranë zyrave të avokatëve me të cilët DNJF ka lidhur kontratë për ofrimin e shërbimit si dhe monitorimit të vazhdueshëm dhe ndjekjes së ecurisë së çështjeve të caktuara me vendim të Dhomave Vendore të Avokatisë. Pas kryerjes së monitorimeve janë hartuar raportet përmbledhës sipas anekseve të bashkalidhura metodologjisë, ku është realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për të 73 ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore. Hartimi i raporteve përfundimtare të vlerësimit të performancës për avokatët që kanë përfunduar çështjet e ndihmës juridike është në proces dhe përfundon javën e dytë të muajit Janar 2021, në përfundim dhe të kontratës vjetore lidhur me DNJF për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore. Gjithashtu, ka përfunduar raportin përmbledhës për të gjitha monitorimet e kryera për avokatët e ndihmës juridike dytësore, duke evidentuar dhe përcjellë dosjet e përfunduara pranë Drejtorisë së Financës, me qëllim kryerjen e pagesës për shërbimet e ofruara.</p> <p>Shkolla e Magjistraturës Shkolla e Magjistraturës miraton në çdo muaj shtator të vitit, kalendarin e trajnimeve të një viti akademik. Tema e “Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti” është përfshirë në kalendarin e trajnimeve për vitin akademik 2019-2020, në datën 20-21 nëntor 2019. Në këtë trajnim morën pjesë 12 gjyqtarë dhe 1 Avokat Shteti.</p> <p>Dhoma Kombëtare e Avokatisë Organizimi i një takimi të përbashkët ndërmjet DHASH dhe Drejtorit të sapoemëruar të DNJF me datë 30 qershor 2020 me qëllim përcaktimin dhe forcimin e bashkëpunimit lidhur me trajnimin e avokatëve të listës së ndihmës juridike dhe hartimin e një programi të vecantë trajnimi për këta të fundit.</p> <p>Sqarim: Lidhur me raportimin e mëparshëm sa i takon procesit të shortit dhe listimit të avokateve sipas këtij të fundit sqarojmë se ky proces është finalizuar brenda afatit ligjor me 1 shkurt. Është</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

									hedhur shorti në DHASH sipas procedurës së përcaktuar në ligjin e ndihmës juridike nr.111/2017. Avokatët janë listuar sipas këtij shorti dhe një kopje e listës së avokatëve sipas shortit i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë me 1 shkurt 2020.
--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave antikorupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale
Nën-objektivi 4/a: Përmirësimi i efikasitetit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë penale sipas standardeve evropiane

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1.Monitorimi i rasteve të paraburgimit për vepra të vogla si dhe të numrit të të miturve në paraburgim (nga procesi i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarëve dhe procesi disiplinor).	KLJG	Identifikimi vjetor i rasteve, analiza në nivel makro dhe nxjerrja e rekomandimeve për institucionet përkatëse.	1800				Realizuar	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor Skema e re e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve është miratuar dhe procesi po vazhdon (shih Nën-objektivi 1/c, pika 5).</p> <p>Sistemi i menaxhimit të çështjeve nuk e gjeneronte një statistikë të tillë deri para përmirësimeve që ju bënë sistemit gjatë vitit 2020. Por, aktualisht pasqyrimi i ndryshimeve të Kodit Penal për të Mitur dhe aplikimi i funksionaliteteve shtesë kanë bërë të mundur gjenerimin e të dhënave statistikore në sistemin ICMS të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Unifikimi i listës për tipet e çështjeve; - Unifikimi i listës për tipet e dispozitiveve; - Evidentimi i çështjeve me të mitur; <p>Në kuadër të përgatitjes së raportit vjetor, për vetë sensitivitetin e çështjes, nga gjykatat kërkohet raportimi për dënimet alternative për çështjet penale me të mitur dhe këto të dhëna janë pjesë e raportit vjetor të KLJG-së.</p>
2.Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme që synojnë:	PP	A) Rritja 2 % çështjeve dërguar në gjykatë për vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore,	2 000					Prokuroria e Përgjithshme Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe kuadrit ligjor për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe iniciimin në Kuvendin e Shqipërisë (Komisionin e

<p>a) Rritjen e eficiencës së hetimit;</p> <p>b) Rritjen e aplikimit të masave të sigurimit të ndryshme nga masa me arrest në burg për veprat penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore (deri në 5 vjet burgim)</p>		<p>krahasuar me vitin 2019</p> <p>B) Rritja 10 % e kërkesave të prokurorit për masa alternative sigurimi të ndryshme nga ajo me burg, krahasuar me 2017 baseline</p>					<p>Realizuar</p>	<p>Ligjeve) për miratim të një shtese në nenin 287 të K.Penal, në përfaqje me nenin 9 (3) të Konventës së KiE-së “Për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimi i terrorizmit” e ratifikuar me ligjin nr.9646/2006, sipas rekomandimit për Shqipërinë nga Konferenca e Palëve të kësaj Konvente të KiE-së me 22/23 Tetor 2019, ashtu dhe në kuadrin e përafritimit të këtij neni të K.Penal me Direktivën (BE) 1673/201 të Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 Tetor 2018 “Për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit”.</p> <p>Udhëzim i Përgjithshëm nr.2, datë 10.03.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”</p> <p>Udhëzim i Përgjithshëm nr.3, datë 19.03.2020 “Për disa masa procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes COVID-19”</p> <p>Udhëzim i Përgjithshëm nr.4, datë 24.03.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”</p> <p>Udhëzim i Përgjithshëm nr.5, datë 08.05.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”</p> <p>Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 është nënshkruar:</p> <p>-Memorandumi i Bashkepunimit mes Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë (përfshi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave) dhe Ministrisë të Brendshme (përfshi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara) “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e asetëve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF dhe planit të veprimit ICRG/FATF”;</p> <p>- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për zbatimin e nenit 59 Te KPrP dhe referimeve që haptazi nuk përmbajnë elementë të</p>
--	--	--	--	--	--	--	------------------	--

							<p>veprave penale;</p> <p>- Akt Koordinimi Ndërinstitucional ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;</p> <p>Gjatë periudhës janar-Dhjetor 2020 janë miratuar:</p> <p>-Udhëzimi i Përgjithshëm nr.7, datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”;</p> <p>-Udhëzimi i Përgjithshëm nr.8, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;</p> <p>-Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 “Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve/pasurive produkt i veprimtarisë kriminale” për krijimin e seksioneve të posaçme në prokurori dhe në strukturat hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit dhe agjensit ligjzbatuese të tjera dhe rritjen/forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në procedurat standarde në veprimtarinë hetimore, polici/agjenci të tjera ligjzbatuese – prokurori;</p> <p>- Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 11, datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”;</p> <p>-Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.</p> <p>- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.17, datë 23.12.2020, “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje”;</p> <p>Analiza e arritjes së treguesve të qëllimit, do të kryhet pasi të administrohen të dhënat vjetore 2020.</p>
<p>3. Garantimi i kushteve të punës sipas standardeve bashkëkohore nëpërmjet:</p> <p>a) Shtimi i stafit mbështetës në funksion të prokurorit;</p>	PP, KLP	Ulje e ngarkesës mesatare për prokuror me 10 % krahasuar me	205 900; për n/masën e ndarë:	99.385; për n/masën b) e ndarë;	KLP 11.000 (në mijë lekë)		<p>Prokuroria e Përgjithshme</p> <p>a) Në Prokurorinë e Përgjithshme janë rekrutuar gjatë vitit 2020:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Drejtor me status civil; - 3 përgjegjës sektori; - 6 specialistë; - 4 sekretare.

<p>b) Investime në infrastrukturë; Ndërtime të reja; Rikonstruksion;</p> <p>c) Trajnimi vazhdues i oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit të nëpunësve civilë.</p>		<p>ngarkesën e vitit 2018</p> <p>Trajnim vazhdues profesiona l</p>	<p>a)192.000; c) 13.900</p>	<p>b) 2 085: 97 300</p>	<p>PP b)66,144</p>	<p>Realizuar</p>	<p>Në prokuroritë e shkallës së parë janë rekrutuar 41 nëpunës, si kryesekretarë, sekretarë, koordinatorë.</p> <p>b) Masa (b) përfshin rikonstruksione në shumën 69.862 mijë lekë. Konkretisht, për vitin 2020 janë planifikuar (buxheti i rishikuar) fonde në total për rikonstruksione 69,862 mijë lekë, nga të cilat shuma 63,430 ishtë planifikuar për rikonstruksion të Prokurorise së Përgjithshme e cila është realizuar 100% (realizimi faktik 63.430 mijë lekë) si dhe shuma 2.314 mijë për Prokurorinë e Rrethit Kurbin (për dëmet nga tërmeti) e cila është realizuar 100% me vlerë 1.898 mijë lekë. Ndërsa shuma prej 3.848 mijë lekë (buxhet i rishikuar) është planifikuar për 9 prokurori dhe përfshin: blerje kangjella e dyer të blinduara në kuadër të ruajtjes së dokumentave.</p> <p>Fondi është realizuar në të gjithë prokuroritë e planifikuara me vlere totale 2.995 mijë lekë.</p> <p>c) Kanë kryer trajnimin detyrues 2 nëpunës civil të cilët kanë qenë në periudhe prove. Në trajnimet online kanë marrë pjesë 4 nëpunës civil.</p> <p>Lidhur me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore, Komisioni i Policisë Gjyqësore dhe Shkolla e Magjistraturës po përgatisin programin e trajnimit fillestar për Oficerë të Policisë Gjyqësore. Ndërkohë për periudhën janar – dhjetor kanë marrë pjesë në trajnime të organizuar nga SHM, rreth 81 Oficerë të Policisë Gjyqësore.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, realizimi i fondit të investimeve në KLP është 17.000 (në mijë lekë), me zëra si me poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pajisje audio video, përkthim simultant i sallës së mbledhjeve plenare; - blerje pajisje TIK; - blerje 3 automjetesh për anëtarët e KLP; - blerje pajisje zyre për sallën e mbledhjeve; - izolim druri për sallën e mbledhjeve; - parket për sallën e mbledhjeve.
--	--	--	---------------------------------	-----------------------------	------------------------	------------------	---

<p>4. Rritja e efencës së përgjimeve në procesin penal, nëpërmjet:</p> <p>a) Realizimi i procesit te decentralizimit të përgjimit të komunikimeve elektronike pranë prokurorive;</p> <p>b) Zgjerimi i kapaciteteve për përgjimin aktiv.</p>	PP	Përgjimet realizohet në secilën prokurori		231.130 lekë			Në proces	<p>Prokuroria e Përgjithshme</p> <p>a) Në lidhje me decentralizimin, Sektori i Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme vazhdon bashkëpunimin me Projektin Pameca 5 për gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme.</p> <p>Gjatë periudhës raportuese kemi vijuar bashkëpunimin me projektin Pameca lidhur me gjetjen e zgjidhjeve teknike për realizimin e kësaj mase.</p> <p>Jemi në proces vlerësimi të tyre.</p> <p>b) Për përgjimin aktiv Sektori Përgjimeve në datë 10.04.2020 ka kryer një trajnim (ëbëinar) mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Social Media Intelligence and OSINT; - Medical Emergency detection system; <p>Pjesmarrës: 3 Oficerë të Policisë Gjyësore Pa kosto për PP.</p>
---	----	---	--	--------------	--	--	-----------	--

Objekti 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar procedurat dhe lehtësirat moderne të sistemeve elektronike për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar
Nën-objekti 5/a: Përmirësimi i gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturë

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
<p>1. Krijimi i një platforme të unifikuar IT për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit. (përfshirë platforma për menaxhimin e çështjeve) (Në funksion dhe të objektivit 1a)</p>	KLGJ	Projektimi, prokurimi i sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve në gjykata (ICMIS të ri).		469.350 lekë			Në proces	<p>Këshilli I Lartë Gjyqësor</p> <p>Këshilli ka ndërmarrë masat e nevojshme për të mundësuar transferimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe kontratat përkatëse nga MD. Ky sistem është marrë në administrim nga KLGJ në muajin shtator të vitit 2019.</p> <p>Gjithashtu, është bashkëpunuar me MD duke dhënë opinion lidhur me projekt-vendimin për ngritjen e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Në zbatim të Urdhërit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 232, datë 4.11.2019 “Për ngritjen e Grupit të Punës, për kryerjen e një studimi, në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve në gjykata”, u realizua studimi dhe Këshilli ju paraqiti një raport analitik, duke renditur problematikat e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata, sipas kategorive të prioriteve, për t’u mbajtur parasysh për përmirësimin e sistemit.</p>

							<p>Raporti i grupit të punës u përdor si bazë e përgatitjes së dokumentave standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike, për kontratën me objekt “Zhvillim, modifikim, përmirësim dhe mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve”</p> <p>Për vitin 2020, KLGJ në bashkëpunim me kompaninë “KREATX” shpk, ka bërë të mundur instalimi i versionit të përmirësuar të sistemit të menaxhimit të çështjeve ICMIS, duke shtuar në këtë version 84 zhvillime të reja, disa nga të cilat shumë të rëndësishme për sistemin gjyqësor dhe punën në KLGJ</p> <p>KLGJ është duke kryer një studim për zhvillimin e projektit në lidhje me sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve. Është parashikuar nevoja për resurse financiare, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë (Misioni EURALIUS V) por kostoja përfundimtare do të përlogaritet në përfundim të miratimit të projektit dhe opsioneve të përzgjedhura.</p> <p>Sistemi i ri pritet të jetë një sistem i unifikuar me mundësinë e bashkëveprimit me sistemet aktuale në përdorim nga institucionet e tjera (Prokuroria, QKB, etj.), në përputhje me praktikën dhe me standardet me të mira ndërkombëtare.</p> <p>Gjithashtu, synohet që i gjithë procesi të përshpejtohet me miratimin e ngritjes dhe venien në funksionim të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë.</p>	
2. Krijimi i qendrës së centralizuar të mbështetjes së funksionimit të TIK (ITOSC) që do të qeverisë sistemet TIK të gjykatave, KLGJ, KLP, ILD.	MD, KM, Qendra TIK	QENDRA ESHTË NE FUNKSIONIM TE PLOTE.		70.803 lekë			Në proces	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Në lidhje me realizimin e kësaj mase, nga ana Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit është hartuar projektvendimi “Për krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”. Aktualisht projektvendimi i është nënshtruar procesit të konsultimit të brendshëm (ministritë e linjës dhe organe të administratës publike), janë mbajtur disa takime me përfaqësues të</p>

								<p>Euralius dhe Justice for All, me synimin e dakordësimit të një drafti.</p> <p>Aktualisht, drafti është në fazë ripunimi në kuadër të komenteve dhe më pas do të vijojë bashkërendimi për mendimet e ardhura.</p> <p>AKSHI</p> <p>AKSHI nuk është i përfshirë aktualisht në këtë projekt dhe për rrjedhojë nuk ka informacion sa i takon krijimit të ITOSC.</p>
3. Blerje dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike për gjykatat	KLJGJ, Gjykatat	96%	175.000 lekë				Realizuar	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>Gjykatat prokuruan fondet e miratuara për blerjen e pajisjeve elektronike. Fondi total i planifikuar për gjykatat për vitin 2020 ishte 33,800 mijë leke. Ky fond është shpërndarë në 26 gjykata të gjitha niveleve. Me këtë fond gjykatat plotësojnë nevojat e tyre me pajisje elektronike si kompjuterat, printer, fotokopje, Server, etj.</p>
4. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (KLJGJ/ILD/KLP)	KLJGJ, KLP, ILD	Sistemi i brendshëm (softi) i menaxhimit të brendshëm në funksion (i veçantë për çdo institucion) Vendosija/ instalimi i pajisjeve IT dhe vënia në funksion e tyre Sistemi i brendshëm (softi) i menaxhimit të brendshëm i zhvilluar (I VECANTE PER CDO INSTITUCION)	110.308 KLJGJ 43.515 KLP 44.640 ILD 22.153				Realizuar	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>Për KLJGJ fondet për blerjen e pajisjeve elektronike (Kompjuterat) ka qenë në vlerën 3,900 mijë lekë. Këto prokurime janë realizuar në masën 93%</p> <p>Aktualisht KLJGJ po merret me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e programeve ekzistuese për menaxhimin e çështjeve gjyqësore.</p> <p>2 gjykatat e posaçme K.K.O. për vitin 2020 kanë patur të miratuar një fond prej 1450 mijë lekë për blerjen e pajisjeve elektronike. i cili është realizuar në masën 94%. me këto fonde është realizuar blerja e kompjuterave, skaner, printer, sistem dhe video konference.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p>Ndihmë/ Dhuratë nga Ambasada Amerikane (OPDAT) në pajisje elektronike (Sipas letër marrëveshjes me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës , më 31.12.2019).</p> <p>Ndihmë/Dhuratë nga Ambasada Amerikane (OPDAT) në pajisje elektronike (Sipas letër marrëveshjes me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara</p>
4.1. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (SPAK/ GJKKKO)	SPAK/ GJKKKO							234 675;

				SPAK 227 970; GJKKKO 6 705 GJPAKKO 1,495 (në mijë lekë)				të Amerikës , më 10.06.2020). Inspektori i Lartë i Drejtësisë Përgjatë periudhës Janar Dhjetor 2020, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është pajisur me infrastrukturën elektronike të nevojshme në përputhje me nevojat e stafit aktual pranë ILD-së. Gjykata e Posaçme e Apelit per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Pajisur me infrastrukturën elektronike të nevojshme. Gjykata e Posaçme e Apelit per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar . Me projektin e financuar nga Buxheti i Sheteit per vitin 2020 “ Blerje pajisje elektronike per GjKKO “u be e mundur blerja e 3 kompjuterave per 3 salla gjyqi, 2 videokonferenca te levizeshme , nje skaner zyre dhe 10 Eëb Camera. Keto pajisje do te ndikojne drejtpersedrejt ne arritjen e objektivit te mesiperem . Projekte me financime te tjera nuk kemi patur.
5.Investim sipas standardeve bashkëkohore në godinat e gjykatave 5.1 Përmirësimi i infrastrukturës së godinave të gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë e Durrës, (rikonstruksion dhe ndërtimi i godinave të reja).	KLGJ, Gjykatat	<u>58%</u>	352.000 lekë				Në proces Këshilli i Lartë Gjyqësor Me buxhetin e detajuar në fillim të vitit 2020 ishte planifikuar të realizohej rikonstruksioni i rrjeteve elektrike, kompjuterike dhe telefonisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë, i cili megjithese me vonese për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të Covid - 19, arriti të realizohej në masën 22,501 mijë lekë, nga 23,700 mijë lekë të detajuara. Investimi i planifikuar për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt hartimin e projektit të zbatimit për godinën e re të gjykatës, nuk u realizua, për shkak se u rivlerësuar fakti që me riorganizimin e gjykatave mund të ndryshojë numri i gjyqtarëve dhe i stafit administrativ. Numri i tyre lidhet me elementë të tillë si numri i zyrave dhe sipërfaqet e vendeve të punës, numri i sallave të gjykimit, etj. Pra është e nevojshme të qartësohen këto të dhëna para se të fillojë investimi në këtë gjykatë. Realizimi i projektit për këtë objekt, mbetet në prioretet e KLGJ –së, e cila do të hartojë planin e saj strategjik për infrastrukturën ndërtimore. Për shkak të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019, një pjesë e fondit të investimeve të vitit	

								2020 (në vlerën 8.435 mijë lekë), u përdor për rikonstrukcion dhe riparimin e gjashtë godinave të dëmtuara: Gj. Rrethit Gjyqësor Tiranë; Gj. Apelit Durrës; Gj. Rrethit Gjyqësor Durrës; Gj. Rrethit Gjyqësor Krujë; Gj. Rrethit Gjyqësor Laç; Gj. Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Gj. Apelit KKO.
6. Përmirësimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke reflektuar në të edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe trajnimi i stafit	PP	Sistemi përdoret 100 % nga përdoruesi t dhe siguron besueshmëri të dhënash		40.230 lekë			Në proces	Prokuroria e Përgjithshme Kompania implementuese ka komunikuar që po punon në këtë drejtim por ende nuk ka zhvillime konkrete. Nuk ka asnjë zhvillim në vitin 2020.
7. Krijimi i kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin e informacionit në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar	PP, MD	Sistemi është funksional		9.730 lekë			Në proces	Prokuroria e Përgjithshme Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë aktualisht janë duke punuar për ndërlidhjen e dy programeve kompjuterike ekzistuese (IMPRO dhe M-File), në mënyrë që të gjenerohen të dhëna përputhshme dhe të ndiqet vijueshmëria e praktikave në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë me shkresën nr 2465/1 Prot, datë 04.05.2020, i ka kërkuar A.K.SH.I-t ndryshimin e arkitekturës së sistemit M-File për të bërë të mundur shkëmbimin e të dhënave me Sistemin IMPRO të Prokurorisë së Përgjithshme. Ndërkohë, përfaqësues të dy Institucioneve (ndërmjet Sekretarëve të Përgjithshëm, punonjësve të Drejtorive të Marrëdhënive Juridiksionale me Jashtë, përfshirë edhe Specialistët IT dhe përfaqësues të AKSHI-t) kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm për të bërë të mundur ndërlidhjen e sistemeve. Ministria e Drejtësisë, pas administrimit të përgjigjes nga AKSHI do nisë diskutimet për termat e referencës dhe nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi për shkëmbimin e të dhënave. Aktualisht nga ana ana e Prokurorisë së Përgjithshme është përgatitur dokumentacioni i duhur për aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, lidhur me regjistrimin e Sistemit IMPRO si databazë

							<p>shtetërore. Një nga kërkesat për regjistrimin e këtij sistemi si databazë shtetërore është që ai nuk duhet të përmbajë/administrojë/përpunojë të dhëna të klasifikuara “Sekret Shtetëror”. Sistemi IMPRO në Prokurorinë e Përgjithshme administrohet nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe të dhënat që përmbahen aty kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, të dhëna këto që shkëmbehen ndërmjet disa institucioneve, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit/ZQK Interpol Tirana, autoriteteve gjyqësore vendase, etj. Problematika e krijuar lidhur me faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dërgon të klasifikuara “Sekret shtetëror” akte të tilla si, njoftimet për arrestimet e subjekteve të shpallur në kërkim ndërkombëtar (për shtetas të huaj dhe shtetas shqiptarë), me qëllim ekstradimin nga dhe për jashtë shtetit, njoftimet për shpalljet në kërkim ndërkombëtar të shtetasve shqiptarë nga autoritetet e huaja gjyqësore, kërkesat për verifikimet e statusit aktual të subjektit, etj. Nga ana jonë i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të bëjë rivlerësimin e klasifikimit për aktet në këtë fushë. Vetëm pas këtij rivlerësimi, Prokuroria e Përgjithshme do të mund të regjistronte pranë AKSHI-t sistemin IMPRO si databazë shtetërore, duke bërë të mundur në vijim ndërlidhjen mes këtij sistemi me Sistemin M-File të Ministrisë së Drejtësisë, në përmbushje të rekomandimeve të MONEYVAL.</p> <p>Gjithashtu PP informon se, është në proces ndërlidhja e dy databazave elektronike të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar përkatësisht të sistemit IMPRO të PP dhe Sistemit MFile të MD. Aktualisht ka përfunduar regjistrimi i Sistemit IMPRO si databazë shtetërore nga AKSHI dhe pritet ndërmarrja e hapave të metejshëm nga MD.</p> <p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Është në process përmirësimi i sistemit për të garantuar aksesin me Prokurorinë e Përgjithshme me qëllim shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit dhe gjenerimin e statistikave koherente, sic është rekomanduar në IO.2 MONEYVAL. Janë përcjellje</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

								pranë AKSHI-t termat e referencës (Terms of Reference) të hartuara në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme. AKSH-i ka filluar procedurën e prokurimit.
8. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme IT në DNJF	MD	Infrastruktura e IT-së mbulohet nga një kontratë mirëmbajtjeje		140.000 lekë			E Prealizuar	Nuk ka zhvillime
9. Përgatitja e një sistemi të integruar për publikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në Fletore Zyrtare dhe Buletin e Njoftimeve Zyrtare, për publikimin e legjislacionit të përditësuar, të kodeve dhe të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave.	QBZ AKSHI	Integrimi i ICMIS me publikimet elektronik e dhe plotësimi/përditësim i i sistemit	69.840 lekë		560.000 lekë (QBZ)		Në proces	<p>Qendra e Botimeve Zyrtare Aktualisht, deri në momentin e këtij raportimi sistemi i QBZ “Arkiva Elektronike” nuk ndërvepron me sisteme të tjera, as me sistemin ICMIS . Qendra e Botimeve Zyrtare është ftuar në takime vetëm për ndërveprim me sistemin e-akte.</p> <p>AKSHI Nuk ka një kërkesë zyrtare nga intitucionet e përfshira që përdorin këto sisteme drejtuar AKSHI-t në mënyrë që të zhvillohen takime me qëllim incimin e këtij procesi për bashkëveprimin e dy sistemeve QBZ/ICMIS, ku ky i fundit është në pronësi të KLGJ, në kuadër të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, neni 277, pika 5.</p>
10. Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore dhe institucionale të Arkivës Gjyqësore (ASHSGJ-së).	ASHSGJ	Mobilimi me rafte arkivore I arkivës së sistemit gjyqësor për pjesën tjetër	51.000 lekë		18.101 (mije lekë)		Në proces	Procedura e rikonstruksionit të godinës u anulua në vitin 2019 dhe kjo masë është rishikuar dhe rivendosur përsëri në vitin 2020. Godina ka përfunduar procesin e rindërtimit dhe është në fazë kolaudimi. Për sa i përket mobilimit me rafte metalike, procesi ka përfunduar dhe raftet janë montuar në sallat arkivore.
11. Krijimi dhe funksionimi i sistemit elektronik të arkivës gjyqësore.	ASHSGJ	Funksioni mi i sistemit elektronik (hedhja e të dhënave)	28.800 lekë				Në proces	<p>Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor Për këtë projekt KLSH ka rekomanduar revokimin e kontratës. Për shqyrtimin e rekomandimit të KLSH është ngritur grupi i punës me qëllim analizimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet palëve. Për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 grupi nuk është mbledhur për shqyrtimin e rekomandimeve të KLSH.</p>

								Ministria e Drejtësisë Në vijim të realizimit të kësaj mase, nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, është hartuar vendimi “ Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”, i cili është miratuar me vendimin nr. 888, datë 31.12.2019, botuar në Fleoren Zyrtare nr. 184, datë 31.12.2019.
Objektivi 6: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit Nën-objektivi 6/a: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 <i>(E realizuar / në proces / e porealizuar)</i>	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
<p>1. Përfshirja e të burgosurve në aktivitete punësimi dhe rritja e numrit të aktiviteteve riintegruese:</p> <p>1.1 Përfshirja e të burgosurve në aktivitete punësimi.</p> <p>1.2 Ofrimi i kurseve të formimit profesional në aftësitë bazë dhe ato teknike.</p> <p>1.3 Ofrimi i programeve të tjera edukative, sportive, sociale dhe kulturore.</p>	DPB	<p>Shtimi i numrit dhe llojit të kurseve profesionale për shtetasit e burgosur.</p> <p>Rritja e përfshirjes së shtetasve që frekuentojnë në procesin e formimit profesional në masën me 15%.</p> <p>Rritja e pjesëmarrjes së shtetasve të privuar nga liria në këto aktivitete në masën 20%.</p>		2 000			Realizuar	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Rehabilitimi dhe ri-integrimi i të burgosurve konsiderohet si thelbi i misionit të sistemit të burgjeve. Në funksion të këtij qëllimi janë ndërmarrë masa të vazhdueshme për të bërë të mundur zbatimin e një regjimi kuptimplotë aktivitetesh për këtë kategori.</p> <p>1.1 Një ndër komponentët bazë të punës ri-integruese që kryhet me personat me liri të kufizuar është aktivizimi i tyre në aktivitete punësimi. Në zbatim të dispozitave ligjore punësimi i të burgosurve konsiderohet si mjet rehabilitues dhe jo ndëshkues. Të burgosurit aktivizohen në aktivitete punësimi, sipas mundësive që ofrojnë institucionet, kryesisht si mirëmbajtës, ndihmës kuzhinier, kopshtar, ndihmës në bibliotekë etj..</p> <p>Gjatë vitit 2020 janë miratuar 5 manuale të rëndësishme për stafet e edukimit për punën rehabilituese me personat me liri të kufizuar, duke përfshirë të miturit, personat me probleme të shëndetit mendor, personat me varësi nga substancat narkotike, të burgosurit me risk të lartë sigurie etj..</p> <p>Ndër të tjera, DPB ka adresuar edhe çështjen e punësimit të burgosurve si një ndër komponentët bazë të punës ri-integruese dhe rehabilituese. Në këtë kuadër janë drejtuar shkresa zyrtare për disa nga shoqatat e biznesit në vend për të mbështetur të burgosurit gjatë burgimit dhe pas lirimit të tyre përmes projekteve të punësimit.</p>

							<p>Për periudhën janar-shtator 2020 janë punësuar mesatarisht në sistemin e burgjeve 542 të burgosur prej të cilëve 110 të paraburgosur.</p> <p>Në kuadër të adresimit të rasteve për riintegrim DPB ka adresuar kërkesa zyrtare pranë 27 bashkive në vend, duke referuar edhe të dhëna konkrete për 425 të burgosur në prag lirim.</p> <p>Një marrëveshje bashkëpunimi është lidhur me Bashkinë e Tiranës për të rritur mundësitë e ri-integrimit të personave me liri të kufizuar pas lirit të tyre.</p> <p>1.2 Nisur nga situata e jashtëzakonshme e COVID 19 dhe si rezultat i masave të marra për parandalimin dhe përhapjen e tij në institucionet e burgimit prej muajit mars e në vijim aktivitetet në grup të burgosurve janë zhvilluar me pjesëmarrjen e një numri të kufizuar të burgosurish, në të cilat përfshihen kurset profesionale dhe programe të tjera edukative.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi kanë bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional për zhvillimin e procesit të formimit profesional në IEVP. Në zbatim të kësaj marrëveshje, procesi i formimit profesional është zhvilluar mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat fizike, si dhe llojet e kurseve profesionale që ofrohen nga DRFP. Për vitin 2020, kurset profesionale janë ofruar në 9 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 351 të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektrikist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldaturë.</p> <p>1.3 Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën aktivitete të tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve gjatë vitit 2020 është 2756. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 192 tema sociale në muaj dhe 37 recensione librash. Gjithashtu, janë zhvilluar 365 aktivitete ri-integruese.</p> <p>Ministria e Drejtësisë Miratimi i ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në funksion të aktiviteteve të përcaktuara për këtë nënobjektiv, ka si qëllim veç të tjerash edhe garantimin e</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>rehabilitimit social dhe riintegrimin në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike të të paraburgosurve dhe të dënuarve madhorë dhe të mitur, duke iu garantuar këtyre të fundit format e motivimit nxitës në përputhje me parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit, ndihmën sociale, edukative, arsimore, psikologjike dhe fizike në përputhje me nevojat individuale dhe në përputhje me grup -moshën, gjininë dhe personalitetin e tij. Ligj ka parashikuar, planin individual për trajtimin e çdo të dënuari, të cilit i ofrohet asistenca nga ekipe multidisiplinare për të inkurajuar rikthimin dhe riintegrimin në shoqëri, ku ndër të tjera është parashikuar edhe punësimi.</p> <p>Ligji garanton se puna e kryer nga i burgosuri shpërblehet dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni. Punësimi i të burgosurit ka si qëllim të garantojë fitimin, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive për punë dhe njohurive profesionale, për riintegrimin në shoqëri pas përfundimit të kryerjes së dënimit.</p> <p>Po kështu, ligji 81/2020, përmes neneve 43 dhe 44, parashikon për garantimin e të drejtës për punësim dhe zgjedhjen e punës që do të kryejë, brenda ose jashtë institucionit. Natyra e punës që kryhet nga i dënuari duhet të jetë në përputhje me gjendjen shëndetësore, njohuritë dhe aftësitë për punë, formimin profesional, karakteristikat e veçanta të personalitetit, si dhe me perspektivën e riintegrimit të tij në shoqëri.</p> <p>Ligji parashikon se i burgosuri punësohet nga administrata e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose nga persona juridikë privatë brenda ose jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve. Megjthatë, ndalohe punësimi jashtë institucionit i të burgosurit, që është vendosur në institucionet e sigurisë së lartë. Kontrata e punësimit e lidhur me një të burgosur nuk duhet të tregojë se ai ose ajo është duke kryer dënimin. Po kështu është vendosur edhe detyrimi për personelin e institucionit, që të nxisë dhe të krijojnë kushte për vetëpunësimin e të dënuarve. Ligji ndalon</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

							shprehimisht punën e detyruar ose punësimin si formë e dënimit disiplinor.
2. Ulja e mbipopullimit në IEVP-të në përputhje me standardet evropiane.	DPB	Reduktim i mbipopullimit në masën 2%	373.000 lekë			Realizuar	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Çështja e mbipopullimit në nivel të përgjithshëm në sistemin e burgjeve është një problematikë e zgjidhur. Kapacitet totale të sistemit të burgjeve janë 6106 vende dhe gjatë janar-shtator 2020 janë trajtuar mesatarisht 4985 persona, prej të cilëve 282 shtetas me masë mjekësore mjekim i detyruar. Niveli i popullimit në fund të muajit shtator 2020 ka qenë mesatarisht -18% (-1121). Pra, sistemi i burgjeve në nivel të përgjithshëm ka qenë në kushtet e nënpopullimit.</p> <p>Krahasuar me vitin 2019, niveli i popullimit të burgjeve është ulur me 6% (pra, nga -12% në -18%). Ulja e popullimit në burgje ka ardhur si rezultat i zbatimit të Ligjit Nr.5/2020 “Për Dhënie Amnistie”, për të cilat janë marrë masat e duhura dhe të nevojshme për efektivitetin e aplikimit të tij në mënyrë sa më rigoroze, në të gjitha IEVP.</p> <p>Mbipopullimi ne total ne te gjithe IEVP Minus 1247, ose – 20% Kanë mbipoullim IEVP Kukës 10 Kruja 42 Elbasan 1 Berat 17 Korçë 81 Vlora 9 Tepelena 18 Sarandë 2</p>
3. Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të të ndaluarve/ të burgosurve me probleme të shëndetit mendor.	DPB		62.629 lekë			Në proces	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Në fund të muajit dhjetor 2019 një plan tranzitor masash është hartuar nga MSH dhe MD në kuadër të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave me masë mjekësore mjekim i detyruar. Zbatimi i planit u planifikua që të përmbyshet gjatë 2020.</p> <p>Në projektet prioritare të investimeve të sistemit të burgjeve përfshihet përfundimi i investimit për adaptimin e godinave 4 dhe 5 në IEVP Lezhë në ambiente spitalore për të trajtuar personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Për vitin 2020 nuk pati fonde të mjaftueshme për të përmbyllur të gjithë investimin. Janë parashikuar fonde në projekt-</p>

							<p>buxhetin e vitit 2021 për përfundimin e gjithë investimit.</p> <p>Aktualisht ka dalë Urdhër Prokurimi për pajisjen e IEVP Lezhë dhe përshtatjen për spital.</p> <p>Është miratuar rritja e pagave të stafit shëndetësor.</p> <p>Gjithashtu, garantimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor, është përcaktuar shprehimisht në nenin 5 të ligjit nr. 81/2020, si një e drejtë themelore. Më tej ligji në nenin 20 ka bërë një ndarje të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Ndërsa për personat me probleme të shëndetit mendor është përcaktuar se personat për të cilat gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor, për sa i takon ofrimin të Shërbimeve, pranë institucionet e kujdesit shëndetësor. Masat e sigurisë për ruajtjen e këtyre institucioneve ofrohen nga Ministria e Drejtësisë.</p> <p>Në nenin 42 të ligjit nr. 81/2020, është përcaktuar edhe Shërbimet e kujdesit shëndetësor për kategori të veçanta se trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor sigurohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor. I burgosuri që gjendet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që ka çrregullime të shëndetit mendor gëzon të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë strukturave shëndetësore të specializuara për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit.</p>	
4. Garantimi i respektimit të të drejtave të të burgosurve	SHKBB	Platforma E Trajtimin Te Ankesave E Konsoliduar		35.000 lekë	1.093 (në mijë lekë)		Në proces	<p>Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve</p> <p>Për periudhën kalendarike, Janar – Dhjetor 2020, në lidhje me masën e 1-rë, “Rishikimi i Kuadrit Ligjor”, nga SHKBB-ja, është përgatitur gjatë vitit kalendarrik 2019 Projekt - Drafti mbi ndryshimin e Ligjit për SHKBB-në, i cili gjatë vitit 2020 u është</p>

							<p>dërguar strukturave përkatëse . Për vitin kalendarik 2020 (nëntor – dhjetor) ishte përfshirë për diskutim në programin dhe kalendarin e punimive të Kuvendit të Shqipërisë. Aktualisht ende nuk është arritur miratimi i këtij ligji që të vazhdojmë me pjesën tjetër të dërgimit për miratim, të paketës ligjore mbi ndryshimin e rregulloreve dhe nxjerrjen e udhëzimeve konform ligjit të ri që pritet të miratohet sa më shpejt.</p> <p>2. Trajtimi i ankesave ka vazhduar normalisht edhe për periudhën Janar –Dhjetor 2020, sipas rasteve të paraqitura në SHKBB-ë. Trajtimi i ankesave të dërguar nga të burgosurit, familjarët vazhdon me efikasitet të plotë nga sektori përkatës, I hetimit dhe Ankesave pranë SHKBB-së, i cili gjatë kësaj periudhe ka regjistruar si të hyra 30 ankesa të ndryshme, prej të cilave janë trajtuar dhe u janë kthyer përgjigje brenda afateve të përcaktuara ligjore. Nga këto ankesa 6 prej tyre janë bërë në rrugë telefonike. Lidhur me trajtimin e ankesave janë bërë informacione të ndryshme në drejtim të Ministrisë të Drejtësisë konkretisht 60 informacione, Drejtorit të SHKBB-së, 56 informacione, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve 20, nga keto edhe 17 sugjerime për marrje masash administrative, si dhe janë dërguar në prokurorinë përkatëse.</p> <p>3. Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, vazhdon plotësimi i databazave të rrjetit të brendshëm të krijuar nga vetë punonjësit, akoma nuk kanë filluar procedurat për krijimin e (ëeb page-numër jeshil), i cili aktualisht nuk ka kosto financiare, pasi këto databaze janë krijuar nga vetë punonjësit për hedhjen e të dhënave në sistem. Janë kryer procedurat drejtuar AKSH-it, për ndërtimin e rrjetit .</p> <p>4. Në bashkëpunim me Inspektoret në IEVP-se, me qëllim efikasitetin në trajtimin e ankesave , është bashkëpunuar në vazhdimesi edhe me sektorin e Hetimit dhe Ankesave mbi problematikat e dala në IEVP-ë.</p> <p>Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informon se, gjatë vitit 2020 janë trajtuar 42971</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>kerkesa dhe ankesa te te burgosurve, stafit dhe qytetareve;</p> <p>Janë ndermarre disa inisiativa për adresimin e të drejtave të burgosurve, që lidhen me trajtimin. Është në proces rishikimi i dietës ushqimore;</p> <p>Janë hapur disa procese për të rishikuar klasifikimin e sigurisë të të burgosurve të sigurisë së lartë, që kanë më pak se 5 vite burgim;</p> <p>Në mungesë të vizitave me familjaret dhe të afermit e tyre, është ofruar shërbimi i komunikimit me video, deri në 30 min në javë;</p> <p>Janë adresuar të gjitha rekomandimet e AP dhe organizatave të pavarura dhe Komisionit të Sigurisë, i cili ka inspektuar kushtet e burjeve etj.</p> <p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit, është në fazë konsultimit të projekligjit, “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale”, i cili është në fazë bashkërendimi të mendimit me institucionet qendrore. Ky projektligj, është konceptuar si një nismë, pjesë e paketës së reformës penitenciare, e cila ka në fokus përmirësimin e kushteve të drejtësisë penale. Nën filozofinë e reformave të ndërmarra, në ndryshim nga ligji ekzistues, ligji i ri zgjeron misionin e shërbimit nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjit dhe interesave qytetarëve shqiptarë, por edhe mbrojtjen e veprimtarisë së mundshme kriminale dhe të kundërligjshme të kryer nga çdo punonjës i strukturave, pavarësisht nga funksioni. Projekligji dukshëm ka në objekt të veprimtarisë së shërbimit, trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të publikut, ndaj punonjësve objekt hetimi, ruajtjen e integritetit të punonjësve, si dhe veprimtarinë kërkimore me qëllim dhënien e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësim në aspekte të organizimit dhe funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në kuadër të rendit dhe sigurisë në burgje. Në konkretizim të sa mësipër, projekligji parashikon edhe një Kre të posaçëm ku parashikohet edhe synimi për të shqyrtuar dhe verifikuar ankesa, ndaj punonjësve të strukturave për mospërbushje të detyrës, sipas standardeve të përcaktuara në</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

										legjislacionin në fuqi, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjore; por edhe parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale dhe shkeljeve të legjislacionit në fuqi, të kryera nga punonjësit e strukturave të cilët janë përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe nga të paraburgosurit, të burgosurit dhe familjarët e tyre. Mbetet e pritshme që kjo nismë të miratohet nga Kuvendi brenda vitit 2020, me qëllimi fillimin e zbatimit të parashikimeve të tij dhe për pasojë ngritjene e platformës për pranimin dhe trajtimin e ankesave.
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

Nën-objektivi 6/b: Përmirësimi i Shërbimit të Provës sipas standardeve evropiane dhe rritja e përdorimit të sanksioneve alternative

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Përmirësimi i infrastrukturës së Shërbimit të Provës	Sh. i Provës	30 % e infrastrukturës së përmirësuar/ ofrim më i mirë i dënimeve alternative	33.400 lekë		4,965,600 lekë		Realizuar	<p>Shërbimi i Provës Gjatë periudhës Janar-Dhjetor është përfunduar rikonstrukcioni i godinës ku kryen aktivitetin DPSHP dhe ZVSHP Tiranë.</p> <p>Janë krijuar kushtet optimale pasi janë marë 9 zyra me qera, duke patur parasysh se ambientet ku zhvillojnë veprimtari këto zyra ishin jo të përshtatshme.</p> <p>Zyrat aktuale të cilat janë marë me qera ofrojnë kushte bashkohore, janë të pajisuara me ambiente dhe bazë material të cilat i përshtaten punës që kryen Shërbimi i Provës duke siguruar një shërbim më cilësor të mbikëqyrjes dhe përkujdesin e të dënuarve.</p>

Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë

Nën-objektivi 7/a: Përmirësimi i procesit të hartimit të politikave, planifikimit dhe proceseve të vlerësimit të sistemit të drejtësisë

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Rritja e kapaciteteve planifikuese dhe monitoruese të Ministrisë së Drejtësisë me qëllim hartimin e politikave efikase mbi sistemin e drejtësisë dhe zbatimin e tyre.	MD, KM	Zbatimi sipas kalendarit të trajnimeve	3.000 lekë				Në proces	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Lidhur me Kapacitetet BNJ raportohet se (6 mujori I 2020 – Totali/5 vende vakante) (6 mujori II 2020/3M III 2020- Totali/ 6 vende vakante). Referuar statusit aktual të kapaciteteve të burimeve njerëzore për kryerjen e “ proceseve të hartimit të politikave, planifikimit dhe proceseve të vlerësimit në fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit”, në vlerësim edhe të përmirësimit të tyre krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2020 vihet re një ulje e nr. të punonjësve, përgjegjës për zbatimin e Nën-objektivit 7/a.</p> <p>Gjithashtu raportohet se Ndjekja e 1 seminari/trajnimi i ka shërbyer aspektit zhvillimor në kuadër të njohurive profesionale si dhe rritjes së performancës së nëpunësit civil në administratën publike me qëllim kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tyre me korrektesë dhe përgjegjshmëri.</p> <p>Kryeministria</p> <p>Në kuadër të funksionalizimit të Sistemit të Informacionit (IPSI) me qëllim rritjen e cilësisë së politikbërjes dhe respektimin e parimeve të planifikimit të integruar, përdorimin më të mirë të burimeve, rritjes së performancës dhe llogaridhënies janë zhvilluar me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të ministrive të linjës në drejtim të monitorimit të politikave/strategjive/planeve të veprimit/programeve zhvillimore, në përputhje me metodologjitë e IPSI kanë vijuar gjatë kësaj periudhe.</p> <p>a) Trajnimi 10-ditor (04- 15 Maj) ToT për 150 përdorues të sistemit IPSI me 5 rrjetet/përdoruesit kryesorë/parësorë të sistemit IPSI (a. Mapping të 5 rrjeteve/kategorizimit të përdoruesve kryesorë të sistemit IPSI): ToT Rrjeti i Politikave në ministritë e linjës (65 pjesëmarrës); ToT Rrjeti i Integritimit</p>

							<p>Evropian në ministrinë e linjës (25 pjesëmarrës); ToT Rrjeti i Projekteve strategjike në ministrinë e linjës (25 pjesëmarrës); ToT Rrjeti i Programeve në ministrinë e linjës (25 pjesëmarrës); ToT Rrjeti Rregullator në ministrinë e linjës (25 pjesëmarrës);</p> <p>b) Trajnim për 50 përdorues të sistemit IPSIS me 5 rrjetet/përdoruesit kryesorë/parësorë të sistemit IPSIS/Rrjetin e Politikave në ministrinë e linjës (qershor).</p> <p>c) Finalizimi i 25 manualeve strukturore të sistemit IPSIS dhe 15 manualeve për cilësinë dhe menaxhimin e të dhënave/indikatoreve të performancës me qëllim zhvillimin e kapaciteteve për sigurimin e standarteve të parashikuara për përdorimin e sistemit IPSIS;</p> <p>d) 8 Ëorkshpe të dedikuara/trajnimi i 120 përdoruesve të sistemit (qershor) me përdoruesit e sistemit/ministrinë e linjës për kuadrin metodologjik lidhur me cilësinë e të dhënave/Indikatorëve të performancës në 8 ëorkshpe të dedikuara lidhur me 4 sektorë: (i) drejtësinë dhe punët e brendshme (ii) financën dhe ekonominë (iii) mbrojtjen sociale dhe shëndetësinë si dhe (iv) infrastrukturën dhe energjinë. (4 raporte trajnimi pas përfundimit të ëorkshpeve të dedikuara)</p> <p>e) Gjithashtu në kuadër të metodologjisë së monitorimit & raportimit janë zhvilluar kontrolle cilësie/dhe dhënë komente për të gjithë institucionet/dhe Ministrinë e Drejtësisë të cilët kanë hartuar raportet e monitorimit për periudhat specifike. Janë zhvilluar për këtë qëllim 8 takime të dedikuara për të krijuar një mjedis mundësues për stafet teknike në njohjen më të thellë lidhur me elementët analitikë të procesit të monitorimit.</p> <p>Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) dhe për kontrollin e cilësisë të Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit, për projektligjet që vijnë për shqyrtim dhe miratim në Këshill të Ministrave, në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të konsultimit publik, kanë përfutur me mbështetjen e BE-së një asistencë</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>teknike 1 vjeçare (nëntor 2019 – nëntor 2020) për përmirësimin e cilësisë së këtyre dy proceseve të rëndësishme.</p> <p>Gjatë muajit janar 2020, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, me qëllim rritjen e kapaciteteve brenda ministrive të linjës, të cilat hartojnë Raportet e vlerësimit të ndikimit, ka koordinuar me ministritë për zgjerimin e Rrjetit të Përhershëm të RIA-s, duke shtuar numrin e anëtarëve nga cdo ministri, ku padyshim përfshihet dhe Ministria e Drejtësisë. Në muajin shkurt 2020 janë organizuar me mbështetjen e ekspertëve të asistencës teknike të BE-së, 4 (katër) seksione trajnimesh për këtë proces, me pjesëmarrjen e pothuaj të gjithë anëtarëve të Rrjetit të RIAs. Janë planifikuar edhe 3 seksione trajnimesh të tjera, të cilat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID_19, janë shtyrë deri sa situata të normalizohet dhe të mund të lejohen organizime trajnimesh. Duke konsideruar që trajnimet e mbetura lidhen me analizimin e kostove, është e pamundur që ato të zhvillohen online për shkak të kompleksitetit të tyre.</p>
2. Krijimi i një sistemi për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator të legjislationit	KM, MD	Trajnime të vazhdueshme për punonjësit dhe për punonjësit e rekrutuar rishtazi.	1.500 lekë				Realizuar	<p>Kryeministria Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) dhe për kontrollin e cilësisë të Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit, për projektligjet që vijnë për shqyrtim dhe miratim në Këshill të Ministrave, në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të konsultimit publik, kanë përfituar me mbështetjen e BE-së një asistencë teknike 1 vjeçare (nëntor 2019 – nëntor 2020) për përmirësimin e cilësisë së këtyre dy proceseve të rëndësishme. Gjatë muajit janar 2020, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, me qëllim rritjen e kapaciteteve brenda ministrive të linjës, të cilat hartojnë Raportet e Vlerësimit të Ndikimit, ka koordinuar me ministritë për zgjerimin e Rrjetit të Përhershëm të RIA-s, duke shtuar numrin e anëtarëve nga cdo ministri, ku padyshim përfshihet dhe Ministria e Drejtësisë. Në muajin shkurt 2020 janë</p>

								organizuar me mbështetjen e ekspertëve të asistencës teknike të BE-së, 4 (katër) seksione trajnimesh për këtë proces, me pjesëmarrjen e pothuaj të gjithë antareve të Rrjetit të RIAs. Janë planifikuar edhe 3 seksione trajnimesh të tjera, të cilat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID_19, janë shtyrë deri sa situata të normalizohet dhe të mund të lejohen organizime trajnimesh.
Nën-objektivi 7/b: Përmirësimi i kapaciteteve të hartimit dhe analizës ligjore dhe për njoftimin dhe konsultimin publik								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Përmirësimi i sistemit të njoftimit publik dhe konsultimit të legjislativitetit	KM, MD	Trajnim: -për plotësimin e regjistrit të konsultimeve; - trajnim për proceset e njoftimit dhe konsultimit	2.400 lekë				Në proces	<p>Kryeministria</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të mekanizmave institucionale për procesin e konsultimit publik qeveria shqiptare po asistohet nga projekti i financuar nga BE "Asistenca teknike për përmirësimin e kornizës rregullatore dhe konsultimin publik" i bashkërenduar nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri (komponenti I/i projektit). Projekti menaxhohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, me objektivin kryesor për të përmirësuar mekanizmat dhe procedurat institucionale në mënyrë që politikëbërja dhe proceset rregullatore të jenë efikase, të mirëinformuara dhe të bazuara në prova dhe të harmonizuara me objektivat dhe qëllimet e politikës.</p> <p>Tre objektivat specifike të projektit lidhen kryesisht me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Forcimin e kapaciteteve për mbikëqyrje, menaxhim dhe bashkërendim të konsultimit publik, sipas fazave të nevojshme dhe të integruara të ciklit të politikave. 2. Përmirësimin dhe mbështetjen për zbatimin e modelit ekzistues të vlerësimit të ndikimit. 3. Përmirësimin dhe mbështetjen e një sistemi efektiv të konsultimit publik dhe komunikimit publik.

							<p>Gjatë kësaj periudhe në kuadër të përmirësimit të procesit të konsultimit publik janë zhvilluar aktivitetet, si më poshtë vijojnë</p> <p>Udhëzim për konsultimet publike të zhvilluara (përfshirë Udhëzimin specifik për përgatitjen e raportit vjetor mbi konsultimet publike /e bashkërenduar dhe me pasaportën e treguesve);</p> <p>Udhëzues për përgatitjen e raporteve vjetore të konsultimeve publike nga ministritë e linjës, me modelet përkatëse për raportim, si dhe Udhëzues për përgatitjen e planit vjetor për konsultime publike me kritere të përpunuara për përfshirjen / përjashtimin e akteve nga konsultimet publike)</p> <ul style="list-style-type: none"> • 27 akte të ministrive të linjës është kryer kontrolli i planeve të konsultimit dhe dokumenteve të konsultimit • 11 ëorkshope të mbajtura për planifikimin dhe raportimin e konsultimeve publike (2 ëorkshope gusht për stafin e ministrive të linjës) • Gjithashtu janë mbështetur ministritë e linjës në zhvillimin e dokumenteve të mëposhtme: • 8 draft raporte gjashtëmujore mbi konsultimet e zhvilluara publike të përgatitura nga ministritë e linjës • 9 drafte të planeve vjetore të konsultimeve publike të ministrive të linjës • rekomandime për përmirësimin e funksionaliteteve të Regjistrit Elektronik për Njoftime dhe Konsultime Publike të dorëzuara në AKSHI dhe ZKM • përmbledhje e përgjigjeve të qeverisë evropiane ndaj COVID-19 në lidhje me praktikën e konsultimit publik me rekomandime për Shqipërinë. <p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Në Ministrinë e Drejtësisë Koordinatori për Konsultimet Publike realizohet si detyrë nga specialist i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit. Në përmbushje të detyrimit që buron nga "Udhërrëfytyesi për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile" 2018 – 2020, Koordinatori për Konsultimet Publike, në Ministrinë e Drejtësisë, ka marrë pjesë në trajnimin një ditor të datës 12 Qershor 2019 për "Konsultimin Publik" të organizuar nga Shkolla Shqiptare e</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

								Administrates Publike, si dhe janë hartuar raportet 3-mujore dhe 6-mujore të konsultimit publik në përputhje me raportimet sektoriale.
Nën-objektivi 7/c: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar sipas standardeve evropiane								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Forcimi i kapaciteteve të MD për të përgatitur rregullimin e legjislacionit vendas sipas <i>acquis communautaire</i>	MD	Përcaktimi i akteve që do të përafrohen me afate konkrete në programin analitik të projekt akteve	1.500 lekë				Në Proces	Ministria e Drejtësisë Sa i takon analizës për të përcaktuar legjislacionin që do të përafrohet, është kryer analiza e akteve që do të përafrohen dhe janë dorëzuar TOC.
2. Rritja e kapaciteteve të departamentit të lidhur me donatorë të ndryshëm në MD.	MD		28.500 lekë				Në proces	Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në fushën e Drejtësisë për periudhën janar – dhjetor 2020 ka ndjekur keto procese: 1. Ëorkshop- Raportimi orientuar drejt rezultatit në asistencën IPA me date 7-8 janar 2020; 2. Ëorkshop mbi hartimin e dokumentit Strategic Responce ne kuader te IPA III me date 3 shkurt 2020; 3. Më datë 29 Qershor 2020 është zhvilluar <i>Ëebinar/mbledhjen e organizuar nga Grupi Tematik i Politikbërjes në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndersektoriale dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndersektorial të integruar”</i> . 4. Më datë 16,17,18 shtator 2020 u zhvillua në Vlorë Ëorkshopi me temë Budget support multi-stakeholder, në të cilën është raportuar edhe mbi ecurinë e deritanishme të Kontratës Sektoriale „BE për Reformën në drejtësi“ 5. Mbi Asistencën teknike në mbështetjen buxhetore të kontratës sektoriale Justice SBS “BE për Reformën në Drejtësi”, implementimi i kontratës TA pritet në

								fillim te vitit 2021, pasi jemi infomuar nga EUD që janë duke ndjekur procedurat.
Nën-objekti 7/d: Përmirësimi i funksionimit të MD dhe institucioneve të saj të varësisë								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Prgatitja e aplikantëve birësues mbi procesin e birësimit me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve.	KSHB	Zhvillimi i seancave të këshillimit të aplikantëve birësues në grupe të ndara; Këshillim për 30 cifte aplikantësh	17.000 lekë		16.447 lekë		Realizuar	Komiteti Shqiptar i Birësimeve Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, janë realizuar në total 13 (trembëdhjetë) seanca këshillimi, gjatë të cilave janë trajnuar dhe informuar mbi procesin e birësimit 19 (nëntëmbëdhjetë) çifte dhe aplikantë të vetëm për birësim. Buxheti i realizuar që i takon seancave të këshillimit të zhvilluara gjatë periudhës raportuese është në masën 16 447 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) lekë. Seancat e këshillimit janë zhvilluar në varësi të numrit të aplikantëve për birësim gjatë vitit 2020.
2. Përmirësimi i legjislacionit të fushës së mjekësisë ligjore dhe akteve të tjera nënligjore.	IML		50 lekë				Në proces	Instituti i Mjekësisë Ligjore Për periudhën e raportimit, raportohet se lidhur me këtë masë janë propozuar projekt aktet në Ministrinë e Drejtësisë.
3. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të IML nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës në IML, në ambientet spitalore (spitali QSUT) si dhe spitaleve në rrethe, në pajisje (laboratori ADN) dhe në stafin/personelin e institucionit.	IML	Pajisje për 6 Institucione Rajonale të Mjekësisë Ligjore. Forcimi sipas rekomandi meve të vlerësimit.	12.040 lekë	255.000 lekë			Në proces	IML Për periudhën raportuese IML ka prokuruar blerje pajisje për morgun dhe laboratorin, në shumën 4.288.800 lekë.
4. Rishikimi i legjislacionit në lidhje me përmbartimin shtetëror	MD/DPP	Miratimi i ndryshimeve të ligjit	50 lekë				Në proces	Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit Me ngritjen e grupit të punës dhe përfundimin e

		Zbatimi i ndryshimeve ligjore.					<p>analizës mbi evidentimin e mangësive për tu adresuar në ndryshime është mundësuar realizimi i projektligjit për “Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor”, miratimi i të cilit është në proces.</p> <p>Ministria e Drejtësisë Në lidhje me këtë masë, sqarohet se rishikimi i ligjit “Për Përbarimin Shtetëror” nuk është përfshirë në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, i miratuar me VKM nr.837 datë 24.12.2019, por Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit do të kontribuojë ndaj çdo nisme që do të ndërmerret për ndryshimin e ligjit “Për Përbarimin Shtetëror”, pasi ai të jetë vlerësuar nevoja e ndërhyrjeve nga struktura përgjegjëse për politikën që ndiqen për institucionet e varësisë.</p>	
5. Përmirësimi i infrastrukturës së godinave të shërbimit të përbarimit shtetëror, infrastrukturës logjistike bashkëkohore (pajisje elektronike, pajisje zyre) dhe pajisja me automjete për kryerjen e detyrave me efektshmëri.	DPP	Zbatimi i investimit për përmirësimin e infrastrukturës së godinës së DPP dhe ZP Tiranë, Fier, Korçë, Lushnjë e Berat; Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Lezhë, Mat, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tropojë, Dibër, Vlorë e Përmet 7.6 % e infrastrukturës logjistike (pajisje elektronike) e përmirësuar; 14% e infrastrukturës logjistike (pajisje zyre) e përmirësuar;	47 000; 6 250; 2 750 (*18); 10 000 (*19); 8 000; 6 000 (*20); 10 000; 4 000 (*21)	550.000 lekë			Pa realizuar	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit Në Buxhetin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror, për vitin 2020, nuk është miratuar fond për investime.
6. Përmirësimi i burimeve njerëzore në këndvështrimin profesional operacional dhe financiar.	DPP	78 PERMBARUES gjyqësor të trajnuar; Zbatimi i rikategorizimit të pagave të shërbimit. Miratimi i projekt propozimit dhe	50.500 lekë				Në proces	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit me evidentimin e nevojave për trajnim ka planifikuar dhe miratuar programin e trajnimit, për vitin 2020, për përmbartesit gjyqësor. Dhe, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid -19, nuk është

		implementimi i organikës së shtuar							mundësuar realizimi i tyre . Me identifikimin e nevojës për një trajtim financiar të përshtatshëm, në masë të mjaftueshme me natyrën e përgjegjësive së funksionit të përmburës gjyqësor, shkallën e vështirësisë në përmbushjen e tij, është bërë propozimet konkrete në projektligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmburimit Gjyqësor Shtetëror”, miratimi i të cilit është në proces.
Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin Nën-objektivi 8/a: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve të lira Ligjore									
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto ⁸ (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020	
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë			
<p>1. Rritja e performancës së drejtorive përgjegjëse për monitorimin e profesioneve të lira ligjore dhe të institucioneve të varësisë në MD, nëpërmjet:</p> <p>1.1 Ngritja e një programi trajnimi për drejtorinë përgjegjëse për monitorimin e profesioneve të lira.</p> <p>1.2 Ngritja e një programi trajnimi për drejtorinë përgjegjëse për monitorimin e institucioneve të varësisë, veçanërisht me fokus</p>	MD	Finalizimi i metodologjisë/manua lit të monitorimit të profesioneve të lira; Kontrole transparente, bazuar në një metodologji të qartë për institucionet e varësisë; Kontrole transparente, bazuar në një metodologji të qartë për profesioneve të lira.	8.900 lekë				Në proces	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Numri total i punonjësve së Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit ka në strukturë 14 punonjës dhe aktualisht ka 3 vende vakante.</p> <p>Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira ka të parashikuar në Strukturë: 8 pozicione, ku gjatë periudhës janar-mars 2020 nuk janë plotësuar të gjitha vakancat. Është një vend i lirë, përkatësisht pozicioni i Drejtorit të Drejtësisë.</p> <p>Përsa i përket Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Tjera të Varësisë ka në strukturë 2+1 pozicione, nuk ka vend vakant.</p>	

⁸ * Buxheti i masave të profesioneve të lira ligjore do të mbulohet nga të ardhurat e vetë Dhomave, si ente private me vetëfinancim.

<p>kontrollin e respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata.</p>									<p>Ndërsa në Sektorin e Monitorimit të Institucioneve të varësisë në fushën penale ka një vend vacant dhe është pozicioni I përgjegjesit të sektorit.</p> <p>Nga Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, gjatë periudhës janar-mars 2020 stafi i sektori u ndryshua. Stafi aktual ka ndjekur trajnim për ndërmjetësimin në dt. 4-6 mars 2020 me tematikë “ Forcimi i sistemit të ndërmjetësimit në Shqipëri”, organizuar nga Norëigian Embassy, Berlin Center for integrative Mediation, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, Fondacioni i pajtimit të mosmarrëveshjeve.</p> <p>Gjithashtu, në muajin Nëntor 2020 është ndjekur trajnimi i organizuar nga GIZ, në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së notereëve, mbi parandalimin dhe pastrimin e parave.</p> <p>Në ligjin nr. 110/2018 “Për Noterinë”, është parashikuar në mënyrë eksplicite detyrimi i Ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse në miratimin e akteve nënligjore.</p> <p>Në 2019 janë janë miratuar aktet, si më poshtë:</p> <p>Urdhër nr. 444 datë 30.09.2019, “Për miratimin e Kodit të Etikës profesionale të noterëve”;</p> <p>Urdhër nr. 445 datë 30.09.2019, “Për miratimin e statutit të Dhomës Kombëtare të Noterisë”;</p> <p>Urdhër nr. 214, datë 21.03.2019 të Ministrit të Drejtërisë, “Për rifreskimine dosjeve të noterëve dhe asistenteve, si dhe formularët përkatës të vetëdeklarimit”, së bashku me Urdhrin për ngritjen e grupit të punës që ndjek këtë proces.</p> <p>Për periudhën janar-dhjetor 2020: Nga ana e strukturave përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë është finalizuar hartimi i draft akteve, si dhe janë miratuar</p>
---	--	--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>aktet si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Urdhër nr. 157, datë 2.6.2020 “Për miratimin e kriterëve të hollësishme për mjedisin e zyrës së noterit”; 2. Urdhër nr. 182, datë 15.06.2020 “Për formën, përmbajtjen dhe administrimin e regjistrave, si dhe për dokumentacionin që përmbajnë dosjet e noterëve, kandidatëve për noter dhe zëvendësnoterëve”; 3. Urdhër nr.180, datë 15.06.2020 “Për njoftimet e akteve jashtëgjyësore nga noterit”; 4. Urdhër nr.163, datë 10.06.2020 “Për caktimin e numrit të ekspertëve të pavarur, masës së shpërblimit si dhe rregullat që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së tyre”; 5. Urdhër nr.179, datë 15.06.2020 “Për miratimin e formularit të ankesave ndaj noterëve dhe zëvendësnoterëve”; 6. Urdhër nr.181, datë 15.06.2020 “Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve për vitin 2020”; 7. Udhëzim nr.7, datë 10.06.2020 “Mbi modalitetet për transferimin e zëvendësnoterit”; 8. Udhëzim nr.8, datë 10.06.2020 “Për garantimin e infrastrukturës për ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, që ofrojnë shërbimin e tyre në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor dhe mënyrën e përballimit të shpenzimeve”; 9. Udhëzim nr.164, datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullave për procedurat e plotësimit të vendeve vakante si noter”; 10. Urdhër nr.165, datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullave për punësimin e kandidatëve për noterë”; 11. Urdhër nr.166, datë 10.06.2020 “Për formën, përmbajtjen dhe karakteristikat e tjera të vulave, si dhe rregullat për pajisjen e dhe administrimin e tyre”; 12. Urdhër nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale,
--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>regjistrave dhe vulave të noterit”;</p> <p>13. Urdhër nr.168, datë 10.06.2020 “Për evidentimin dhe marrjen në dorëzim të arkivave të padorëzuara ndër vite”;</p> <p>14. Urdhër nr.169, datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dher verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor”;</p> <p>15. Urdhër nr.170, datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullores për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor;</p> <p>16. Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë, nr. 16 datë 30.07.2020, “Mbi rregullat për trajtimin e transaksioneve financiare të një noteri, rregullat për trajtimin e fondeve të një klienti ose të një pale të tretë”</p> <p>17. Udhëzimi nr. 20 datë 14.06.2020, “Për përcaktimin e procedurës për kryerjen e pagesave në rastet e kalimit të pasurive të paluajtshme”</p> <p>18. Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr. 260 datë 30.07.2020, “Për miratimin e rregullave në lidhje me kushtet e përgjithshme për statusin e zëvendës noterit dhe kushtet kontraktuale të detyrueshme për kontratën e punës së zëvendës noterit”</p> <p>19. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 20.10.2020 “Për përcaktimin e tarifave të shpërblimit të noterit, për kryerjen e veprimeve dhe akteve noteriale”</p> <p>20. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.346, datë 15.10.2020 “Për miratimin e rregullores së programit të detyrueshëm të formimit fillestar për kandidatët për noter “</p> <p>21. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.344, datë 15.10.2020 “Për miratimin e rregullores së programit të detyrueshëm të formimit vazhdues për</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

- kandidadët për noter’’
22. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.345, datë 15.10.2020 «Për miratimin e rregullores së Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve »
 23. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.347, datë 15.10.2020 «Për miratimin e rregullores së provimit ë kualifikimit »
 24. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.354, datë 20.10.2020 «Për miratimin e Rregullores mbi mënyrën e organizimit të provimit të pranimit në formimin fillestar për noter »
 25. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.23, datë 07.12.2020 «Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumentave noteriale, si dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale përfshirë formatin e tyre dhe Formën, përmëbajtjen, verifikimin e rregullueshmërisë dhe administrimin e regjistrave të veprimtarisë noteriale »
 26. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.7, datë 07.01.2021, «Për krijimin dhe përdorimin e dokumenteve elektronike noteriale »
 27. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.5, datë 07.01.2021 «Për rregullat e hollësishme për regjistrin kombëtar të testamenteve dhe për regjistrin kombëtar të dëshimive të trashëgimisë »
 28. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.1, datë 07.01.2021 «Për rregullat e detajuara për ndreqjen e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale »
 29. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.2, datë 07.01.2021 «Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e veprimeve dhe akteve noteriale »
 30. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.3, datë 07.01.2021 «Për mënyrën e dixhitalizimit, administrimit, ruajtjes dhe dorëzimit të arkivës në format

							<p>dixhital nga noterët »</p> <p>31. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.6, datë 07.01.2021 « Për krijimin, administrimin dhe aksesin në arkivën elektronike të noterisë »</p> <p>Për më tepër, është miratuar Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr.408, datë 03.12.2020 « Për miratimin e standardeve dhe metodologjinë e inspektimit të veprimtarisë së noterëve », i cili është realizuar në bashkëpunim me ekspertë të Euralius.</p> <p>Është ngritur Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve, e cila do të sjellë garantimin e rekrutimit të kandidatëve më të mirë për noter, zhvillimin e mëtejshëm profesional të kandidatëve, noterëve dhe zëvendësnoterëve me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor kundrejt qytetarëve.</p> <p>Gjithashtu, me zgjedhjen e 2 anëtarëve që caktohen nga Ministri i Drejtësisë, është ngritur Bordi Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Noterisë.</p>
<p>2.Rritja dhe forcimi profesional i avokatëve në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve nëpërmjet konsolidimit të programeve trajnuese të ofruara nga Shkolla e Avokatisë;</p> <p>Program i Edukimit Profesional të ofruar nga Shkolla e Avokatisë për trajnimin e avokatëve në mbarë vendin.</p>	<p>Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë</p>	<p>Organizim i i trajnimit vazhdues DUKE PERDUNDUAR TRAJNIMIN E TE GJITHE AVOKATEVE NE RRETHE.</p>		<p>7.000 lekë</p>			<p>Në proces</p> <p>Dhoma Kombëtare e Avokatisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnim online 2-ditor me avokatët e Dhomës së Avokatisë Vlorë, me temë “Ankimi Individual Kushtetues” I organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman IRZ, 13-14 Maj 2020; 2. Trajnim online 2-ditor me avokatet e Dhomës së Avokatisë Elbasan, me temë “Ankimi Individual Kushtetues” I organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman IRZ, shtator 2020; 3. Kick off seminar trajnimi me Programin HELP të Këshillit të Europës mbi “Drejtësinë miqësore për të Miturit dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur” për specializimin e avokateve të listës së ndihmës juridike, 12-13 tetor 2020; 4. Seminar trajnimi (ToT) in depth mbi nenin 10 të KEDNJ, “Mbrojtja dhe Siguria e Gazetarëve sipas standardeve të Këshillit të Europës dhe legjisllacionit

								<p>Kombëtar”, 30 Tetor 2020;</p> <p>5. Trajnim online 2-ditor me avokatët e Dhomave të Avokatisë Lezhë dhe Shkodër, me temë “Ankimi Individual Kushtetues” I organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman IRZ, 11-12 nëntor 2020;</p> <p>6. Trajnim online me avokatet e Dhomës së Avokatisë Tiranë, I organizuar në bashkëpunim me Berlin Center for Integrative Mediation, Qendra e Ndërmjetësimit Tiranë, 23 Nëntor 2020;</p> <p>7. Trajnim online me avokatët nga Dhomat e Avokatisë Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Vlorë i organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman IRZ me teme: “Avokati në Pubik”, 9 Dhjetor 2020.</p>
<p>3. Ngritja e një programi specifik trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të grupeve vulnerable veçanërisht për të miturit në konflikt me ligjin</p>	<p>Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë; Shkolla e Avokatisë Në bashkëpunim me Këshillin e Europës,</p>	<p>Përgatitja e moduleve të trajnimit mbi viktimat, dhe grupe të tjera vulnerabël Vazhdimi i organizimi të trajnimeve vazhduese mbi drejtësinë për të miturit;</p>	<p>3.000 lekë</p>				<p>Në proces</p> <p>Dhoma Kombëtare e Avokatisë</p> <p>1. Gjatë vitit 2020 DHASH me mbështetjen e organizates Terre des Homme ka përgatitur:</p> <p>i) një Udhëzues për Avokate mbi “Drejtësinë Miqësore për të Miturit dhe rolin e Avokatit në aplikimin e drejtësisë restauruese, masat alternative si shmangia dhe ndërmjetesimi për të miturit në konflikt me ligjin”;</p> <p>ii) një Modul Trajnimi për Rolin e Avokatit në Aplikimin e Drejtësisë Restauruese dhe alternativat e tjera të dënimit për të miturit në konflikt me ligjin”;</p> <p>iii) në Tetor 2020 është zhvilluar trajnimi me avokatet që do të ofrojnë ndihme juridike të garantuar nga Shteti.</p> <p>2. DHASH në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhimes Juridike Falas kanë hartuar një draft program me temat kryesore mbi të cilat do të trajnohen avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore. Projekti do t’i nënshtrohet diskutimeve me organizata ndërkombetare dhe lokale te cilat japin kontribut dhe operojnë në fushën e ndihmes juridike falas. Në shkurt 2021, pas miratimit të listës me avokatët që do të ofrojnë ndihmën juridike do të fillojë dhe trajnimi i tyre.</p> <p>3. Lidhur me të drejtat e fëmijëve, veçanërisht të fëmijeve në konflikt me ligjin dhe zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës, në datat 12-13 Tetor 2020 u zhvillua Kick off seminar online mbi “Drejtësinë miqësore për të Miturit dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur” për specializimin e</p>	

							avokatëve të listës së ndihmës juridike; 4. Në trajnim kanë marrë pjesë 25 avokatë dhe certifikimi i tyre do të bëhet në fund të muajit janar 2021.
4. Ngritja e Qendrës së Trajnimeve për noterët në Republikën e Shqipërisë; 4.1 Vlerësimi i noterëve sipas krediteve	DHKN	Seanca trajnimi sipas programit të miratuar (gjithsej 4 seanca/vit) ; Vlerësim i noterëve.		1.400 lekë			Në proces Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve Për periudhën raportuese raportohet se është ngritur Qendra e trajnimeve. Është caktuar edhe drejtoresha e kësaj Qendre. Deri më tani nuk kanë filluar vlerësimet me kredite për noterët. Janë parashikuar të kryhen disa seminare online, kjo edhe në kushtet e situatës së krijuar prej përhapjes së virusit covid 19.
5. Krijimi dhe funksionimi i sistemit elektronik N.I.S.A., që siguron lidhje online në kohë reale të veprimtarisë së noterit me shërbimet publike.	DHKN	Funksiona lizimi i plotë i sistemit		1,072.800 lekë			Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve Sistemi NISA funksionon rregullisht.
6. Përmirësimi i kuadrit ligjor pas hyrjes në fuqi të ndryshimit të ligjit mbi ndërmjetësimin	DHKNd	Rishikim i manualit të tarifave të shërbimit të ndërmjetësimit.		5.000 lekë			Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve Është miratuar draft manuali i rishikuar i tarifave të ndërmjetësimit, në mbledhjen e përgjithshme të ndërmjetësve, dhe është dërguar për miratim në Ministrinë e Drejtësisë. DHKNd mbetet në pritje të këtij miratimi.
7. Ngritja e Dhomave vendore dhe ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit; 7.1 Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve nëpërmjet organizimit të trajnimeve fillestarë, të vazhduar dhe gjithashtu trajnim i trajnerëve	DHKNd	HAPJA E ZYRAVE, Trajnim fillestar; Trajnimi vazhduar (30 - 50 ndërmjetës)		53.030 lekë			Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve Është hapur Zyra e Tiranës dhe Zyra e Durrësit. Është realizuar trajnimi fillestar për mndërmjetësit dhe në vijim është parashikuar edhe trajnimi vazhduar në muajt tetor, nëntor, dhjetor 2020. Është kryer edhe një trajnim i vazhduar online mbi procedurat e aplikimeve dhe referimet nga gjykata dhe prokuroria në dy zyrat e hapura.
8. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për shërbimin e ndërmjetësimit në vend	DHKNd	Media; Fletëpalosje dhe broshura; Fushatë informuese në shkolla dhe universitete; Takime me institucione publike dhe jopublike, notere, avokatë, jurisë		3.000 lekë			Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve Lidhur me realizimin e këtij objekti raportohet se janë realizuar fletëpalosjet dhe broshurat përkatëse të cilat janë shpërndarë gjatë fushatës informuese të ndërmarrë nga Dhoma, në shkolla dhe universitete. Janë zhvilluar edhe takime të tjera në funksion të arritjes së këtij objekti.

		dhe ekspertë						
9. Finalizimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor në fuqi, që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor gjyqësor privat, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi.	MD, Kuvendi, DHKPGJP	Nuk ka të parashikuar për 2020	Pa kosto shtesë, pasi përballohet me kontributin e stafëve përkatëse të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës.				Realizuar	<p>Ministria e Drejtësisë Është miratuar në datën 08.05.2019 ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”. Në zbatim të ligjit të sipër cituar, janë miratuar këto akte nënligjore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 142 datë 13.05.2020, “Për përcaktimin e adresave të postës elektronike për komunikimin yzrtar me MD” 2. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 220 datë 17.07.2020, “Për miratimin e formulave të ankesave për Përbarusit Gjyqësor Privat” 3. Urdhër I Ministrit të Drejtësisë nr. 190 datë 22.06.202, “Për përcaktimin t listës së dokumenteve që dorëyohen dhe formatin e vetëdeklarimit të të dhjënave” 4. Urdhër I Ministrit të Drejtësisë nr. 189 datë 22.06.2020, {Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për konstituimin, organiyimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor” 5. Urdhër nr. 197 date 22.06.2020, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Komisionit Disiplinor” 6. Urdhër nr.134 date 27.04.2020, “Për miratimin e formës, modaliteteve dhe të dhënave që përmban raporti statistikor i veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor privat” 7. Urdhër nr. 13 date 17.07.2020, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërblimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur, të cilët do të

								<p>angazhohen në kryerjen e kontrollit të përmbuesve gjyqësorë privatë”</p> <p>8. Urdhër nr. 11 date 17.07.2020, “Për përcaktimin e rregullave për modalitetet, afatet dhe mënyrën e caktimit të përmbuesit gjyqësor privat zëvendësues”</p> <p>9. Urdhër nr. 12 date 17.07.2020, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbuesi gjyqësor privat dhe/ose zyrat e përmbuarimit privat, arkivit dhe vulës personale”</p> <p>10. Urdhër nr. 137 date 27.04.2020, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm”</p> <p>11. Urdhër nr.133 date 27.04.2020, “Për miratimin e formatit të regjistrit të përmbuesve gjyqësorë privatë, regjistrit unik të të dhënave për zyrat përmbare dhe përmbuesit gjyqësorë privatë dhe regjistrit të ndihmës përmbuesve, si dhe mënyrës së mbajtjes dhe përditësimit të të dhënave në to”</p> <p>12. Urdhër nr.135 date 27.04.2020, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin si ndihmës përmbare”</p> <p>13. Urdhër nr. 219 date 17.07.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivave”</p> <p>14. Urdhër Nr. 136, datë 27.4.2020 "Për miratimin e Kodit të Etikës Profesionale të Përmbuesit Gjyqësor Privat”.</p> <p>15. Urdhër nr. 268 date 03.08.2020, “Për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe rregullave të administrimit të Regjistrit të Ndërmjetësve dhe dosjes personale të ndërmjetësve”</p> <p>16. Urdhër nr. 267 date 03.08.2020, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në një shtet të huaj”.</p> <p>Gjithashtu, me zgjedhjen e 1 anëtari që caktohet nga Ministri i Drejtësisë, është ngritur Komisioni Disiplinor i Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.</p> <p>Kuvendi Kuvendi si organ ligjvënës ka miratuar ndryshimin e kuadrit ligjor në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbauesve Gjyqësor Privat si pjesë e paketës së Reformës në Drejtësi me miratimin e ligjit nr. 26/2019.”Për Shërbimin përmbauesve Gjyqësor Privat “</p> <p>Mbetet detyrimi i MD dhe DH.K.P.G.J.P për të nxjerrë aktet nenligjore për të cilat ka kaluar dhe afati i parashikuar në ligj.</p>
<p>10. Forcimi i kapaciteteve profesionale të përmbauesve gjyqësorë privatë;</p> <p>10.1 planifikimi i trajnimeve sipas nevojave, mbështetur në analizën e ankesave dhe mangësive të konstatuara nga DHKPGJP dhe MD gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së përmbauesve gjyqësorë privatë;</p> <p>10.2 Përgatitja e kurrikulave të trajnimit;</p> <p>10.3 Organizimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme (në varësi dhe të ndryshimeve ligjore);</p> <p>10.4 Përlllogaritje e kostove të funksionimit të qendrës së trajnimeve;</p>	DHKPGJP, MD	<p>(10.2 dhe 10.3) Rishikim periodik i kurrikulave të trajnimit, sipas nevojave në zhvillim.</p> <p>Qendra e Trajnimeve pranë DHKPGJP -së, funksional e dhe në shërbim të trajnimit periodik të përmbauesve.</p>	7.000 lekë			E përcaktuar	Nuk ka zhvillime	

10.5 Ngritjen e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.								
<p>11.1 Kryerja e një analize mbi nevojën e zgjerimit të aksesit në bazat e të dhënave shtetërore të shërbimit përmbauesve gjyqësor;</p> <p>11.2 Nxitja e lidhjes së marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit;</p> <p>11.3 Ndërveprimi në kohë reale i sistemeve elektronike të shërbimit përmbauesve me sisteme të tjera shtetërore dhe baza të dhënash shtetërore dhe/ose me ente private.</p>	DHKPGJP, MD	Nuk ka të parashikuar për 2020		90.000 lekë			Në proces	<p>Ministria e Drejtësisë Në lidhje me ndërveprimin e sistemeve elektronike të shërbimit përmbauesve me sisteme të tjera, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020. Në planin e projektakteve që do të propozohen gjatë vitit 2020, të miratuar me vendimin nr. 837, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave është planifikuar që të propozohet vendimi “Për përcaktimin e mënyrës së mbajtjes së regjistrimit qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimin me baza të tjera të të dhënave shtetërore”. Aktualisht ka filluar puna për vlerësimin paraprak të disa çështjeve teknike të sistemit.</p> <p>Në lidhje me masën 11.2, për periudhën janar-mars 2020 nuk ka marrëveshje të lidhura dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit.</p> <p>Në lidhje me masën 11.3, nga ana e Drejtësisë së Hartimit të Legjislativës, është evidentuar si nevojë e përfshirjes së projektvendimit “Për përcaktimin e mënyrës së mbajtjes së regjistrimit qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave shtetërore” në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, i miratuar me VKM nr.837 datë 24.12.2019.</p> <p>Ky projektvendim është planifikuar të propozohet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave, gjatë katërmujorit të III-të të vitit 2020.</p>

										Me Urdhrin nr.342, datë 13.10.2020, të Ministrisë të Drejtësisë, është miratuar Rregullorja për administrimin dhe përcaktimin e roleve që kanë të drejta aksesi në bazën e të dhënave shtetërore "Albis", e cila i është dërguar Dhomës Kombëtare të Përmbuesve Gjyqësorë Privatë me qëllim ndjekjen e procedurave respektive dhe marrjen e masave për njoftimin e përmbuesve gjyqësorë privatë. Aktualisht, sistemi ALBIS është funksional.
Nën-objektivi 8/b: Krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin										
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019-2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (në mijë lekë) (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2020 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2020		
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë				
1. Hartimi i kuadrit ligjor vendas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike me arbitrazh.	MD, Kuvendi	Njoftimi publik dhe ndërmjarrja e aktiviteteve të njoftuesve për zbatimin e zgjidhjeve me arbitrazh; Trajnime	2.332 lekë				Në proces	<p>Kuvendi Në kuvendin e Shqipërisë nuk ka të depozituar ndonjë nismë ligjore në lidhje me hartimin e Kuadrit ligjor vendas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike me arbitrazh.</p> <p>Ministria e Drejtësisë Projektligji është në fazë konsultim me ekspertët e fushës dhe akademikë. Pas përmbylljes së fazës së konsultimit projektligji do të ripunohet, në drejtim të komenteve të marra. Mbetet e pritshme që nisma të miratohet brenda vitit 2020.</p>		